**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNO RAVNOPRAVNOST /
AGENCY OF GENDER EQUALITY

# PREZANTIMI I GRAVE NË MEDIAT E SHKRUARA 2016 – 2019

Prishtinë, 2021

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNO RAVNOPRAVNOST / AGENCY OF GENDER EQUALITY

# PREZANTIMI I GRAVE NË MEDIAT E SHKRUARA 2016 – 2019

Mbështetur nga Qeveria Suedeze – Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtare – SIDA

Sweden
Sverige

Prishtinë, 2021

Hulumtimi dhe raport është përgatitur nga OJQ ''Ekovizioni''.

Te gjitha te drejtat e këtij dokumenti i takojnë Agjencisë për Barazi Gjinore(ABGJ), Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Pikëpamjet e shprehura ne ketë botim nuk janë domosdoshmërish ato te SIDA dhe ABGJ-se.

# Përmbajtja


Lista e grafikoneve ..... 4
Lista e tabelave ..... 4
Shkurtesat ..... 5
Përmbledhje ekzekutive ..... 6
Hyrje ..... 8
1. Korniza ligjore dhe institucionale ..... 10
2. Hulumtimet dhe raportet e mëparshme ..... 17
3. Analiza sasiore e materialit të mbledhur ..... 21
    3.1. Metodologjia e punës ..... 21
    3.2. Gjetjet e analizës kryesore ..... 21
4. Analiza Kritike e Diskursit dhe Analiza Semiotike Multimodale ..... 41
    4.1. Analiza sasiore e materialit të mbledhur ..... 41
    4.2. Mostra e analizës cilësore ..... 44
5. Intervistat e thella gjysmë të strukturuara me kryeredaktor dhe redaktor ..... 71
    5.1. Metodologjia e punës hulumtuese ..... 71
    5.2. Gjetjet kryesore nga hulumtimi ..... 71
Përfundimet dhe rekomandimet ..... 75
Referencat ..... 77

# Lista e grafikoneve

**Grafikoni 1**: Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë në mediat e shkruara gjatë vitit 2016 – 2019 ...... 23

**Grafikoni 2**: Hapësira e ndarë nga mediat e shkruara sipas temave ....... 25

**Grafikoni 3**: Krahasimi i dy gazetave ditore për hapësirën e ndare sipas temave ...... 27

**Grafikoni 4**: Hapësira e politikës e ndarë në tema ...... 29

**Grafikoni 5**: Pasqyrimi i dhunës ndaj grave sipas temave në mediat e shkruara ...... 31

**Grafikoni 6**: Hapësira e ndarë për gratë në sport ...... 32

**Grafikoni 7**: Hapësira e ndarë për gratë në kulturë ...... 33

**Grafikoni 8**: Hapësira e ndarë për gratë në shëndetësi ...... 35

**Grafikoni 9**: Hapësira e ndarë për tema për barazinë gjinore ...... 36

**Grafikoni 10**: Hapësira e ndarë për gratë në ekonomi ...... 39

# Lista e tabelave

**Tabela 1**: Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë sipas numrit dhe përqindjes së artikujve ...... 24

**Tabela 2**: Hapësira e ndarë sipas temave në mediat e shkruara 2016 – 2019 ..... 26

**Tabela 3**: Hapësira e politikës e ndarë në tema sipas gazetave ditore 2016-2019 ...... 30

# Shkurtesat

| | |
|---|---|
| ABGJ | Agjencia për Barazi Gjinore |
| AGK | Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| CEDAW | Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| EIGE | Instituti Evropian për Barazi Gjinore |
| KE | Komisioni Evropian |
| KPM | Komisioni i Pavarur i Mediave |
| KMShK | Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| PKBGj | Programi i Kosovës për Barazi Gjinore |
| RrGGK | Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës |
| TNGJM | Treguesit me Ndjeshmëri Gjinore për Mediat |
| UNESCO | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë |
| ZKM | Zyra e Kryeministrit |

# Përmbledhje ekzekutive

Hulumtimi "Prezantimi i Grave në mediat e shkruara 2016 – 2019", është vlerësim dhe analizë e artikujve të monitoruar dhe mbledhur nga Agjencia për Barazi Gjinore të 5 gazetave ditore: *Kosova Sot, Koha Ditore, Bota Sot, Zëri dhe Epoka e Re,* të mbledhura gjatë viteve 2016 – 2019 . Ky hulumtim ka për qëllim që të vlerësoj prezantimin sasior dhe cilësor të grave në mediat e shkruara gjatë viteve, analizimin dhe vlerësimin e shkrimeve në gazetat ditore në këtë periudhë, të cilat kanë pasur një rol me rëndësi në edukimin dhe informimin e opinionit publik, si dhe analizës rreth rolit të mediave në luftimin e stereotipeve gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore, si çështje thelbësore për zhvillimin e shoqërisë kosovare.

Gjithashtu, hulumtimi ka synuar që përmes nxjerrjes së fakteve dhe të dhënave të tjera relevante, të analizojë gjendjen e grave dhe portretizimin e tyre në media, përfshirë këtu vlerësimet, perceptimet, etiketimet, sfondin e barazisë gjinore, trajtimin e artikujve në sfondin gjinor, hapësirën e ofruar mediatike, prezantimin narrativ dhe vizual, si dhe çështje të tjera, të cilat ndërlidhen me pasqyrimin e grave në mediat e shkruara.

Hulumtimi ka dal si rezultat i nevojës për monitorim periodik përmes realizmit të hulumtimeve periodike, bazuar nga kërkesat që burojnë nga korniza ligjore respektivisht të Ligjit për Barazi Gjinore L 05/20

Në përgjithësi, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se mediat e shkruara gradualisht kanë shënuar progres hap pas hapi, përfshirë këtu edhe disa nga çështjet dhe komponentët kyçe të raportimeve për çështjet gjinore, të cilat ndikojnë në zhvillimin dhe promovimin e përgjithshëm të barazisë gjinore në Kosovë. Në hulumtim është vërejtur qasja dhe gatishmëria e gazetave ditore për t'iu dhënë hapësirë më të madhe grave dhe vajzave në fusha të ndryshme me hapësirat e dedikuara në ballina, si dhje elaborime të storieve të suksesit dhe artikujve. Në këtë drejtim, prezantimi i xhudistes kosovare Majlinda Kelmendi dhe arritja e fitores në lojërat olimpike të Rio-s në Brazil si kampione olimpike, sportistja e parë shqiptare që ka arritur në këtë stad, është vetëm njëra nga storiet më të përfaqësuara përmes artikujve të cilat kanë rezervuar hapësirë goxha të rëndësishme në kuadër të gazetave ditore.

Kultura padyshim se ka gjetur hapësirë gjatë kësaj periudhe në artikujt e shfaqur në gazetat ditore. Këto artikuj kanë folur në mënyrë profesionale

dhe jo-diskriminuese, duke fokusuar në trajtimin e temave që kanë të bëjnë me suksesin e grave dhe vajzave në këtë fushë. Kësisoj, gjatë kësaj periudhe, në pjesën më të madhe të rasteve, raportimi ka qenë objektiv, profesional dhe i paanshëm, gjë që gratë dhe vajzat janë pasqyruar nga perspektiva gjinore. Vërehet një vëmendje e shtuar në fushën e muzikës nën ndikimin e sukeseve te Rita Ora, Dua Lipa dhe promovimi i kryeqytetit të Kosovës Prishtinës, përmes organizimit të festivialit '*Sunny Hill*', pastaj sopranoja Inva Mula, këngëtarja Era Istrefi, pastaj gratë dhe filmi me fokus tek Arta Dobroshi, Yllka Gashi, Adriana Matoshi, etj.

Ggratë në këtë periudhë kanë zënë hapësirë të konsiderueshme edhe në fushën e politikës dhe vendimmarrjes në vend dhe jashtë vendit. Në këtë drejtim, vërehet se ka pasur një përfaqësim të grave në kuadër të fushës së politikës, duke përfshirë këtu: (ish) presidenten Jahjaga, kryetaren e komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila, Edita Tahiri, pastaj deputeten Flora Brovina, Vjosa Osmanin, Besa Gaxherri, Hikmete Bajramin Megjithëse, në pjesën më të madhe të artikujve, pjesa e narracionit në këtë fushë ka një qasje objektive dhe profesionale, megjithatë ka nevojë për përmirësime, sepse në disa artikuj shpeshherë vërehet mungesa e hulumtimeve më të thella me citime qoftë nga protagonistët e ngjarjeve apo akterët tjerë të cilët kanë mundur të japin kontribut për temat në fjalë.

Thënë në përgjithësi, struktura dhe qasja e prezantimit është vërejtur se ka përmirësim, mirëpo prapë vërehet se ka mungesë të trajtimeve profesionale të gazetarëve në aspektin e barazisë gjinore, sidomos me rastin e raportimeve të cilët me ose pa arsye pasqyrojnë artikuj të tillë. Një gjë e tillë vërehet më shumë gjatë analizës së artikujve që kanë të bëjnë me shpërfaqjen e fenomeneve negative, përkatësisht me dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe dhunën ndaj fëmijëve.

Gratë dhe aktivitetit i tyre në jetën publike dhe politike vazhdojnë të jenë jo mjaftueshëm të prezantuar në mediat e shkruara, përmbajnë stereotipe gjinore , minimizojnë diskriminimin dhe kjo është brengosëse sepse mediat krijojnë opinion dhe mbetën një nga aleatët më të rëndësishme në luftimin e pa barazive gjinore

*Prishtinë, 2021.*

# Hyrje

Zhvillimi i mediave ka bërë që bota të ketë një orientim tjetër shoqëror, ndikimi i tyre është i jashtëzakonisht i lartë në perceptimet dhe idetë tona lidhur me shumë çështje shoqërore, në veçanti për rolin e grave në shoqëri. Këtë zhvillim e ka fuqizuar edhe më shumë avancimi i teknologjisë informative dhe përdorimi i gjerë i internetit, i cili ka imponuar transformimin e gazetarisë shtypur në atë digjitale. Ky segment është vërejtur në të gjitha shtetet dhe shoqëritë, përfshirë këtu edhe Kosovën. Sipas të dhënave në nivel global "jetojnë 7.75 miliardë njerëz, prej tyre 5.19 miliardë janë përdorues unik të telefonave të mençur, 4.54 miliardë përdorues të internetit dhe 3.80 miliardë njerëz janë përdorues aktiv të mediave sociale"[1]. Ndërsa, në Kosovë, bazuar nga të dhënat e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, "përqindja e ekonomive familjare të cilat kishin qasje në internet nga shtëpia në vitin 2020 ishte 96.4%, ku krahasuar me vitet 2018 dhe 2019 vërehet një rritje prej 3.2 % në vitin 2020. Në vitin 2020 tek personat në ekonomitë familjare që kanë pasur qasje në internet në shtëpi dominon grup mosha 35-44 vjeç ku 19.5% kanë pasur qasje në internet në shtëpi, nga çfarëdo pajisje, krahasuar me vitin 2019 vërehet një rënie prej 1%. përdorimi i internetit nga meshkujt dominon me 57.4%, krahasuar me femrat me 40.2%. Krahasuar me vitin 2019 tek përdoruesit e internetit meshkuj ka pasur një rritje prej 1.6%, ndërsa tek gjinia femër ka pasur rritje prej 1.5%"[2] . Kjo do të thotë se krahas ndryshimeve të cilat janë bërë në nivel global lidhur me rritjen e përdorimit të internetit, edhe Kosova nuk është përjashtuar nga ky segment.

Në anën tjetër, edhe televizioni nuk e ka humbur ndikimin social që ka, madje sipas një informate të publikuar nga Ballkan.info, në vitin 2018 del se megjithatë "televizioni ende mbetet një burim i rëndësishëm i informimit gjithandej botës. Edhe në Kosovë, televizioni ndiqet në masë të madhe (s'ka shtëpi pa televizor). Sipas këtij mediumi, referuar një hulumtimi të bërë nga Instituti i Prishtinës për Studime të Opinionit Publik, i cili nxjerr rezultatet se cilat janë televizionet më të ndjekura në Kosovë. Në pyetjen e hulumtimit "ju lutem na thoni cilin kanal televiziv e pëlqen më së shumti", vendin e parë e ndajnë dy televizione, Klan Kosova dhe RTK-ja me nga 22 për qind. Në vendin e dytë, si televizioni i tretë, renditet RTV Dukagjini me 16 për qind. Më pas vijnë RTV 21 me 13 për qind, KTV me 12, T7 me 5, Tribuna dhe Rrokum me 1 për qind, etj"[3]

1 https://wearesocial-net.s3-eu-west-1.amazonaws.com/wp-content/uploads/common/reports/digital-2020/digital-2020-global.pdf, qasur më 22.06.2021.

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës: "Anketa e Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2020", Seria 5: Statistikat Sociale, ASK, Prishtinë, 2020, fq. 4-6.

3 https://ballkani.info/hulumtimi-ja-cilat-jane-televizionet-me-te-shikuara-ne-kosove-renditja-foto/, qasur më 22.06.2021.

Pavarësisht këtij fakti, vërehet se qasja e shfrytëzimit të internetit, përkatësisht mediave sociale, është rritur dukshëm, megjithëse ende nuk ka një mekanizëm matës i cili flet për përqindjen e saktë të kësaj çështjeje.

Sido që të jetë, duke parë ndryshimet dhe zhvillimet sociale në botë, por edhe në Kosovë, mediat e shkruara gradualisht janë transferuar në botën digjitale, ku disa nga to madje kanë bërë abonime që përmes pagesave mujore/vjetore të kenë qasje lexuesit. Shikuar në aspektin praktik, ky transformim ndërlidhet me përdoruesit aktiv të internetit, ku mund të vërehet se gazetat ditore tashmë kanë transformuar edhe lexuesit e tyre, të cilat më parë lexonin gazetat e shtypura, ndërsa tani lexojnë ato përmes formës virtuale (online).

Përkundër faktit që gazetat ditore filluan të transformohen në formën digjitale, hulumtimi i zhvilluar në periudhën 2016 – 2019 ka treguar se megjithatë gazetat ishin një burim i rëndësishëm i informimit të qytetarëve në Kosovë. Roli i gazetave në këtë drejtim, është me mjaftë ndikim, pavarësisht mënyrës se si i ofrohet lexuesit. Kjo lë të kuptohet se përmes gazetave qytetarët dhe opinioni i gjerë janë informuar në baza ditore mbi zhvillimet dhe aktualitetin ditorë. Përveç kësaj, kompanitë mediale të gazetave, kanë pasur një rol të rëndësishëm në profesionalizimin dhe nxitjen e zhvillimit të konkurrencës përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale të gazetarëve përmes trajnimeve, shkollimeve jashtë vendit, si dhe shkëmbimit të përvojave me gazetarët e rajonit dhe më gjerë. Gjithashtu, gazetarët janë kontribues të zhvillimit të kuadrove të reja përmes ofrimit të eksperiencës në çështjet e rëndësishme shoqërore.

Prandaj, duke parë rolin e mediave të shkruara në periudhën 2016 – 2019, ky hulumtim ka pasur për qëllim analizën e portretizimit të gruas në mediat e shkruara. Për më shumë ky hulumtim përshkruan gjendjen faktike të përshkrimit të grave në media, si dhe hapësirën e dedikuar për gratë dhe vajzat përmes shkrimeve, teksteve dhe artikujve të publikuar.

Analiza po ashtu synon që të kontribuojë në çështjen e balancimit gjinorë në sferat e ndryshme të shoqërisë, luftimin e stereotipeve gjinor, pabarazinë gjinore në mediat e shkruara, vështrimin kritik mbi objektivitetin, etikën dhe profesionalizmin e gazetarëve në trajtimin e problematikave në artikuj. Të dhënat e këtij hulumtimi mund të shërbejnë institucioneve publike të vendit, shoqërisë civile, komunitetit akademik, mediave, si dhe akterëve tjerë relevant për diskursin publik që zhvillohet dhe për temat që lidhen me çështjen gjinore, përkatësisht për gratë në mediat e shkruara.

# 1. Korniza ligjore dhe institucionale

Të drejtat e njeriut janë parime fundamentale, të patjetërsueshme dhe universale, të cilat njerëzve iu takojnë që në lindje, ato janë edhe të drejta dhe liri natyrore, ku secili njeri që lind i gëzon ato, dhe se askush nuk mund t'ia mohon ato të drejta. Pra, të drejtat e njeriut janë të drejta të patjetërsueshme, i takojnë njësoj çdo personi për vetë faktin se është njëri, pavarësisht nga raca, kombësia ose përkatësia në një grup të dhënë shoqëror"[4] Të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe segmentin e barazisë gjinore si pjesë e pandashme e tyre, janë të garantuara me Kartat dhe dokumentet universale, si dhe aktet më të larta të shteteve të cilat të cilat kanë përqafuar demokracinë. Në Kosovë, të drejtat e njeriut, përfshirë edhe barazinë gjinore, janë të garantuara me aktin më të lartë juridiko – politik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, garanton dhe afirmon parimet e barazisë gjinore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe ndalon çfarëdo forme të diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin në baza gjinore. Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kapitulli II, paragrafi 1 dhe 2 thekson se "Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal"[5]

Kosova edhe pse ende nuk është palë nënshkruese e marrëveshjeve kryesore ndërkombëtare, të gjitha instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme. Këto instrumente po ashtu janë paraqitur edhe në kuadër të Kushtetutës së Kosovës, Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive

4 Mc Lean Iain *"Fjalor Politik i Oxfordit"*, Shtëpia e librit dhe komunikimit, Tiranë 2001, fq. 110.
5 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II, neni 24, paragrafi 1 dhe 2.

Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”[6]

Një tjetër dokument shumë i rëndësishëm i miratuar në vitin 2011 në Stamboll i cili njihet ndryshe edhe si ‘Konventa e Stambollit’, është një instrument ligjor për parandalimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave. Kjo Konventë me një ndryshim kushtetues të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në tetor të vitit 2020 është bërë pjesë kushtetuese e Republikës së Kosovës. Konventa, ndër të tjera thekson se “sipas rastit, palët marrin hapat e nevojshme për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje të tilla si barazia midis burrave dhe grave, rolet gjinore të pasteriotipizuara, respekti i ndërsjellë, zgjidhja e konflikteve pa dhunë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhuna gjinore kundër grave dhe e drejta për integritet personal, të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore. 2 Palët marrin hapat e nevojshme për të promovuar parimet e përmendura në paragrafin 1 në mjediset informale arsimore, si dhe në mjedise sportive, kulturore dhe argëtuese dhe media”[7]

Po ashtu, Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është pjesë e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, përkatësisht Nenit 22 të saj dhe në rast konflikti, ka prioritet ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Konventa është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979 dhe është ratifikuar nga 190 prej 195 shteteve anëtare të OKB-së. Preambula e saj rikujton që “eliminimi i diskriminimit ndaj grave dhe nxitja e barazisë midis burrave dhe grave janë të drejta themelore të cilësuara dhe të detyruara sipas Kartës së të Drejtave të Njeriut. Në preambulë theksohet se zhvillimi i plotë i një vendi, çështjet që shqetësojnë botën mbarë, si dhe çështjet e paqes kërkojnë përpjekje maksimale nga të dy gjinitë si burrat ashtu edhe gratë”[8]

6 Po aty, kapitulli I, neni 22.

7 Këshilli i Evropës: “*Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*”, KE, Stamboll, 11.V.2011, neni 14.

8 Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave, UNFPA, Tiranë, fq. 11-12.

Me pranimin e Konventës, shtetet mund të zbatojnë ligjërisht këto parime në praktikë. Ato janë të detyruara të marrin një sërë masash për të ndaluar diskriminimin ndaj gruas në të gjitha format, si:

- Integrimin e parimeve dhe te drejtave të barazisë gjinore në sistemin ligjor, nëpërmjet shfuqizimit të legjislacionit diskriminues, dhe hartimit të ligjeve që luftojnë diskriminim gjinor;
- Përmes ngritjes së gjykatave dhe institucioneve të tjera për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të grave dhe përparimin e statusit të tyre në mënyrë sa më efektive;
- Duke hartuar dhe zbatuar politika publike të ndjeshme për gruan"[9]

Një dokument tjetër po ashtu i rëndësishëm është edhe Strategjia për Barazi Gjinore 2020 – 2025 e Bashkimit Evropian, e cila paraqet objektivat dhe veprimet e politikës për të bërë progres të rëndësishëm deri në vitin 2025 drejt një Evrope me barazi të plotë gjinore. Qëllimi i strategjisë është që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, të jenë të lirë që të ndjekin rrugën e tyre që kanë zgjedhur në jetë, të kenë mundësi të barabarta për t'u zhvilluar dhe të marrin pjesë dhe udhëheqin në mënyrë të barabartë në shoqëri. Strategjia thekson se "Promovimi i barazisë midis grave dhe burrave është një detyrë për Bashkimin, në të gjitha aktivitetet e tij, të kërkuara nga Traktatet. Barazia gjinore është një vlerë thelbësore e BE-së, një e drejtë themelore dhe parimi kryesor i Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale"[10] Ky dokument strategjik përfshinë veprime të ndërmarra nga institucionet e BE-së, shtetet anëtare, pastaj nga përfaqësues të shoqërisë civile, partnerëve socialë dhe sektorit privat. Komisioni Evropian, kujdeset për të ndërmarrë veprime për të përmbushur objektivat e kësaj strategjie. Në këtë segment, në baza vjetore hartohen raporte vjetore të cilat "përfshijnë të dhëna, përfshirë Eurostat dhe Eurofound, si tregues për matjen e progresit, duke u bazuar në Indeksin vjetor të EIGE të Barazisë Gjinore të BE"[11]

Çështja e promovimit dhe zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës rregullohet me pakon e legjislacionit për të drejtat e njeriut. Korniza ligjore e Kosovës lidhur me barazinë ndërmjet grave dhe burrave është plotësuar me Ligjin për Barazinë Gjinore (Nr. 05/L-020), i cili garanton, mbron dhe promovon barazinë gjinore si vlerë demokratike dhe kërkon pjesëmarrjen dhe kontributin e të

9 Po aty.
10 European Commission: "A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025", shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN
11 https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/qanda_20_357, qasur me datë 19.06.2021

dy gjinive në sferën publike, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe në sferat tjera. Ligji përcakton "masat e përgjithshme dhe të veçanta për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta të femrave dhe meshkujve, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre"[12]

Ligji për barazi gjinore, trajton edhe aspektet e barazisë gjinore në mes të burrave dhe grave, trajtimin e barabartë në mes të tyre në sferën sociale, diskriminimin gjinor, mundësitë e barabartë të pjesëmarrjes, ngacmimin seksual, masat që duhet ndërmarrë për garantimin e këtyre të drejtave nga institucionet e vendit, aspektin e buxhetimit dhe integrimin gjinor, dhunën në baza gjinore, viktimizimin, si dhe stereotipet gjinore. Ky ligj synon që të promovon standardet më të larta demokratike në vend, avancimin e barazisë gjinore, "përfundimin e dhunës me bazë gjinore, sfidimin e stereotipeve gjinore, mbylljen e boshllëqeve (zbrazëtirave) gjinore në tregun e punës, arritjen e pjesëmarrjes së barabartë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, adresimin e hendekut të pagave dhe pensioneve gjinore, mbylljen e hendekut të kujdesit gjinor, si dhe arritjen e ekuilibrit gjinor në vendimmarrje dhe në politikë"[13] të cilat janë të theksuara edhe në strategjinë e re të BE-së, si vlerë thelbësore për një shoqëri demokratike.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, (PKBGj), i hartuar nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ), i cili është miratuar me vendimin e qeverisë Nr. 01/34 të datës 23 maj të vitit 2020, qëllimi i së cilës është përfshirja e plotë e barazisë gjinore në politikat dhe programet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky dokument synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Dokumenti përmban: tri shtylla kryesore: Shtylla I - Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale, Shtylla II - Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore dhe Shtylla III - Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria, një objektivë të përgjithshëm strategjik të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore i cili siguron që barazia gjinore të jetë në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave,

12 Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 2.

13 European Commission: *"A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025"*, shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN

procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve, si dhe tri objektiva strategjike: Objektivi Strategjik 1: Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar në / nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithë përfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale, Objektivi strategjik 2: Avancimi i barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipeve gjinore, si dhe Objektivi strategjik 3: Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore”[14]

Objektivi i dytë dhe i tretë strategjik i PKBGJ-së thekson rolin dhe rëndësinë në avancimin dhe promovimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithë përfshirjes, shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor. Gjithashtu, ky objektiv synon zhdukjen e pabarazive e stereotipeve gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në vendimmarrje, paqe, siguri, drejtësi, si garantues kruacial i arritjes së barazisë gjinore në vend. Në kuadër të këtyre objektivave strategjike, PKBGJ vënë theks të kontribuoj në: avancimin e zhvillimit njerëzor me anë të gjithëpërfshirës sociale, politike dhe ekonomike të vajzave dhe grave në arsim, kujdes dhe edukim shëndetësor, transformimit të strukturave shtypëse gjinore me qëllim të avancimit të barazisë dhe demokracisë shoqërore dhe Krijimin e një sistemi monitorues dhe raportues për imazhin e grave në media. Lidhur me këtë në një hulumtim të realizuar nga Sinani dhe Matoshi me temë ‘portretizimin e gruas në reklama’, nënvizojnë se: “pjesëmarrje (prezencë) të përbashkët të grave dhe të burrave ka pasur në 14 prej 17 reklamave, apo në masën 82.35%, kurse në 3 reklama, apo në 27.65% të tyre gratë nuk janë pjesëmarrëse fare. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e burrave është në 100% të reklamave, kurse e grave në 82.35%. Në 13 nga 14 reklama ku kemi pjesëmarrje të përbashkët të grave dhe burrave, apo në 92.85% të tyre figura e burrit paraqitet në rol kryesor dhe pozicion dominues ndaj gruas, kurse gruaja paraqitet në rol dytësor dhe në pozicion inferior”[15]

14 Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: *“Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024”*, AGJB, Prishtinë, 2020, fq. 10-12, shih: https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024%20-%20SHQIP%20-%20FINAL.pdf

15 Sinani, Resul & Matoshi, Erzë: *“Portretizimi i gruas në reklamat e birrës PEJA”*, Euser, Prishtinë, 2020, fq. 14.

Prandaj, duke parë imazhet e grave në medie dhe portretizimin e gruas sot, PKBGJ përmes objektivave të saj synon që të realizojnë të drejtat e barabarta në vendimmarrje përmes integrimit të perspektivës gjinore në ligje dhe politika, fuqizim të mekanizmave institucional për qasjen në drejtësi dhe krijim të një ambienti të sigurte dhe jo diskriminues për gratë dhe burrat në sektorin e sigurisë dhe në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit.

Gjithashtu, korniza ligjore dhe institucionale e cila fokusohet në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave përfshinë edhe legjislacionin primar dhe sekondar. Lidhur me legjislacionin primar përfshihen edhe: Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje Nr. 03/L-182, Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26, Ligji i Familjes Nr.2004/32, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr. 05/L-021, Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr. 03/L-154 dhe Ligji i Punës Nr. 03/L-212. Korniza zhvillimore për promovimin e Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e Grave përfshinë edhe dokumentet strategjike, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Programi i Reformave Ekonomike, Strategjia për Rregullim më të Mirë, Strategjia Nacionale dhe Plani i veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qarkorja Vjetore Buxhetore, Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026, Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019 – 2023 dhe Strategjitë e tjera.

Në anën tjetër, ekzistojnë mekanizma institucional të cilat merren me rregullimin, monitorimin dhe raportimin e mediave në Kosovë. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) përgjegjësi e të cilit është "të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audiovizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare"[16] Ky komision, si organ i pavarur dhe kompetentë për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e mediave, është përgjegjës po ashtu edhe për sanksionimin e medieve në rast të shkeljeve ligjore.

Gjithashtu, ekziston edhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, i cili "është një trup vetërregullues i formuar për dhe nga sektori i mediave të shkruara. Misioni i tij mbështetet mbi bindjet e Kodit

16 Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 3.

të Mediave të Shkruara të Kosovës. KMShK është themeluar me ndihmën e OSBE-së në Kosovë në shtator të vitit 2005, ndërsa Zyra e KMShK-së aktivitetin e rregullt e ka filluar në dhjetor të vitit 2005”[17] Ky këshill ka hartuar edhe ‘Kodin etik për mediat e shkruara’ i cili ndër të tjera parasheh që “gazetarët dhe redaktorët do të respektojnë parimet etike në vijim dhe do të mbrojnë integritetin profesional të gazetarisë. Redaktorët dhe botuesit do të sigurojnë që i mbarë stafi relevant punues është i informuar për këtë Kod. Tutje, ata do të sigurojnë respektimin e të gjitha dispozitave të këtij Kodi”[18]

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) si organizatë joqeveritare që mbulon çështjen e mediave në Kosovë, ka “mision promovimin, inkurajimin dhe përmirësimin e gazetarisë cilësore dhe të hapur në Kosovë, si dhe pozitën e gazetarëve në Kosovë”[19] . Ky asociacion përveç tjerash, promovon një gazetari të lirë, të pavarur dhe profesionale me qëllim të sjelljes konform kodit etik si dhe ngritjen e vetëdijes së gazetarëve mbi etikën profesionale.

17 https://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/, qasur me datë 18.06.2021.
18 Këshilli i Pavarur i Mediave të Shkruara: “Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës”, KPMSH, shih: http://www.presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf
19 http://agk-ks.org/rreth-nesh/, qasur me datë 18.06.2021.

## 2. Hulumtimet dhe raportet e mëparshme

Mediat konsiderohen agjent të socializimit të cilat kanë një rol dhe rëndësi të madhe në zhvillimin e shoqërisë. Ato konsiderohen si pushtet i katërt pas atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Qëllimi kryesor i medias është komunikimi dhe informimi i qytetarëve përmes pasqyrimit të ngjarjeve dhe zhvillimeve që ndodhin në shoqëri. Masivizimi i mediave ka bërë që ato sot të jenë produkt i globalizmit dhe të kenë ndikime të mëdha në zhvillimin e vetë jetës. Ekziston një raport në mes të mediave dhe fuqizimit të grave, për shkak se "ato marrin rol të rëndësishëm në modernizimin e shoqërisë"[20] dhe në stereotipizimin e vetë shoqërisë.

Për të gjithë ata që mendojnë lidhur me segmentin e barazisë gjinore, segmenti në fjalë nuk është vetëm thjesht fakti se sa gratë përfaqësohen në media ose numri i përfaqësimit të tyre, por edhe fakti se si ato përfaqësohen. Kjo për shkak se mënyra e përfaqësimit të grave, hapësira kushtuar atyre, përmbajtja, gjuha, forma dhe koha, padyshim se kanë një rol me rëndësi dhe japin një pasqyrë mbi gjendjen e stadit të zhvillimit të shoqërisë.

Mediat "(gazetat, radio, televizioni) dhe teknologjitë e reja janë pjesë e kulturës dhe shoqërisë. Pranohet gjerësisht se mediat janë përcjellës të kulturës dhe motorët e globalizimit të kulturave. Mediat mund të konsiderohen edhe si faktorë shoqërorë në vetvete që kanë pushtetin dhe forcën t'i japin shtysë zhvillimit shoqëror. Siç është shprehur edhe Amarthya Sen në një thënie të saj tashmë mjaft të famshme: " asnjëherë më parë nuk ka pasur varfëri në masë atje ku ka media të lira. Këtu mund të shtohen edhe ofruesit e informacionit të lirë, si interneti, bibliotekat, arkivat, muzetë, etj"[21]

Sot, mund të themi se mediat "ndodhen përballë presionit të stereotipeve, të krijuara nga vetë shoqëria, të cilat sipas sociologëve formohen gjatë tre fazave të mëposhtme: a) faza e parë është ajo e transmetimit të stereotipet gjinore të mjedisit ku individi jeton e ku që në komunikimin e parë një vajzë trajtohet ndryshe nga një djalë; b) faza e dytë është ajo e konsolidimit të aftësive dalluese", ku stereotipet gjinore dhe normat kulturore bëhen përcaktuese. Stereotipet gjinore mbi rolet gjinore, si: "Burri – zot i familjes, zot i pronës. Gruaja – nënë, zonjë shtëpie e edukatore e denjë për fëmijët e saj; dhe c) faza e tretë përfshin "pjekurinë sociale, shoqërizimin dhe shkëputjen nga

20 Berisha, Ibrahim: "Medie – Agjensët e Komunikimit", AAB, Prishtinë, fq. 45.

21 UNESCO: "*Gender-Sensitive Indicators for Media – Framework of Indicators to Gauge Gender Sensitivity in Media Operations and Content*", Paris, 2012, shih: https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000217831, qasur me datë 10.05.2021.

stereotipat. Individi, cilësdo gjini, në sajë të eksperiencës e personalitetit fillon të vërë në pikëpyetje tërë njohuritë e fituara duke kërkuar të adoptojë sjellje dhe qëndrime të ndryshme nga ato të imponuara me parë"[22]

Në fakt, roli i mediave nuk mund të jetë vetëm pasqyrimi ad-hoc i ngjarjeve ose mesazheve përcjellëse, por mediat duhet bërë përpjekje që të ndryshojnë gjendjen e përgjithshme të shoqërisë, në respektimin e të drejtave të garantuara me ligj për pjesëmarrje dhe përfaqësim adekuat në të gjitha sferat e jetës nga perspektiva gjinore.

Natyrisht, se "gazetarët nuk mund të mbahen përgjegjësit e vetëm për gjallimin e pabarazisë gjinore. Gazetarët janë vetëm një pjesë e industrisë mediatike, që na përcjell imazhe të deformuara ose klishe të gruas dhe burrit, përfshirë reklamat, filmat artistikë, shoëbiz-i, programet zbavitëse, etj. Por, si informues dhe mbikëqyrës të jetës sonë publike, gazetarët kanë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e gjendjes dhe përmirësimin e raportimit me perspektivë gjinore"[23]. Ndaj nëse gazetarët/gazetaret, do të kenë përgatitje adekuate, njohuri thelbësore mbi të drejtat e garantuar dhe ekspertizë për të përfaqësuar në mënyrë të balancuar dhe integruar këndvështrim gjinorë në produktet mediatike, ata/ato do të arrinin të zbatonin kornizën ligjore në fjalë, të promovonin një shoqëri e cila bazohet në vlera dhe meritokraci duke i ofruar hapësirë të balancuar qytetarëve qofshin gra ose burra.

Prandaj, që mediat të jenë pasqyrime të sakta të shoqërive tona dhe të prodhojnë informacione që janë të plota dhe të shumëllojshme, "është me rëndësi kritike që lajmet në veçanti, ta pasqyrojnë botën në një mënyrë që thellohet përtej një këndvështrimi mashkull-centrik dhe stereotipik. Të gjithë gazetarët mund të luajnë rol në zgjerimin e horizonteve të të menduarit për barazinë gjinore dhe stereotipet me bazë gjinore në media dhe që përcillen përmes mediave. Treguesit me Ndjeshmëri Gjinore për Mediat (TNGJM), përkatësisht *treguesi portretizimi gjinor në përmbajtjen e mediave, e cila përfshinë portretizimi gjinor në lajme dhe çështjet aktuale dhe portretizimi gjinor në reklama dhe publicitet*, synojnë të trajtojnë pikërisht këtë kryqëzim të rrugëve ndërmjet fuqizimit të grave dhe zhvillimit të mediave. Fokusi kryesor i tyre është barazia dhe përmasat gjinore të larmisë shoqërore në media"[24]

Monitorimi i mediave globale në vitin 2015 thekson se "vetëm 24% e

22 Mema, Bresida: *"Barazia Gjinore në Media"*, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë, 2004, fq. 34.
23 Kolgeci, Sulçe Valbona: *"Të ndryshosh narrativën për gratë në media"*, FES, Tiranë, 2020, fq. 12.
24 UNESCO: "Gender-Sensitive Indicators for Media – Framework of Indicators to Gauge Gender Sensitivity in Media Operations and Content", Paris, 2012, shih: https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000217831, qasur me datë 10.05.2021.

subjekteve të lajmeve (njerëzit në lajme) janë gra"[25] kundrejt 76% e pjesës tjetër e cila dominohet nga burrat. Ndërsa, autorja Tenzin Norzom në një raport të saj kushtuar 'perspektivës gjinore në mediat globale' thekson se në vitin 2019 "15-30% e protagonistëve në lajmet për 6 shtete botërore (Mbretëria e Bashkuar, Kenia, SHBA, India, Afrika Jugore dhe Nigeria) kanë qenë gra"[26] Në një studim tjetër të realizuar nga Organizata IMS (*International Media Support*) theksohet se "një shumicë e përmbajtjes mediatike portretizon gratë në role stereotipike siç janë: shtëpiake, modele ose viktima. Pastaj, gratë kanë më shumë gjasa se burrat që të referohen në lidhje me atributet sipërfaqësore siç janë: pamja, mosha, rrobat dhe statusi martesor. Nga ana tjetër, burrat kanë më shumë të ngjarë të portretizohen si figura të fuqishme publike, me mediat që përqendrohen në profesion, aftësi dhe mendime. Kjo përjetëson një perceptim kufizues dhe të pabarabartë të gjinisë. Po ashtu, studimi i tyre nënvizon se "vetëm 4% e të gjitha gazetave, radiove dhe raporteve televizive në mbarë botën sfidojnë stereotipet gjinore, 24% e subjekteve të lajmeve - personat që intervistohen, ose për të cilët ka të bëjë me lajmet - janë gra. Gratë përdoren si eksperte vetëm në 19% të kohës dhe rreth 16% e lajmeve që lidhen me politikën dhe qeverinë, gratë janë subjekt i narracioneve"[27]

Bazuar nga këto të dhëna, shihet se edhe përkundër faktit që Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim e cila është themeluar në Konferencën e Katërt Botërore të Grave, të mbajtur në 15 shtator të vitit 1995, ka shprehur vendosmërinë për të avancuar qëllimet e barazisë, zhvillimit dhe paqes për gratë kudo në botë, në dobi të të gjithë njerëzimit. Kjo deklaratë ka bërë thirrje për ndryshimin e paraqitjes së vazhdueshme të imazhit negativ dhe degradues për gratë në komunikimet mediatike - ato elektronike, të shtypura, dhe audiovizuele. Pavarësisht kësaj, realiteti tregon se ende gjendja nuk është përmirësuar dhe gratë vazhdojnë të kenë hapësirë jo të duhur në raport me burrat, shpeshherë të portretizohen në kontekst negativ, steriotipizues dhe diskriminues.

Barazia gjinore si vlerë sublime edhe e vendeve të zhvilluara evropiane ka gjetur hapësirë të konsiderueshme në këtë kontinent qysh herët, megjithëse jo në masë të duhur edhe përkundër faktit të zhvillimit gradual të këtyre vendeve. Në një raport analitik të vitit 2019 të hartuar nga Këshilli i Evropës me titull '*Barazia gjinore dhe media*' theksohet se përderisa bota feston 25

---

25 GMMP: "*The Global Media Monitoring Project*", shih: https://whomakesthenews.org/wp-content/uploads/who-makes-the-news/Imported/reports_2010/highlights/highlights_en.pdf

26 Norzom, Tenzin: "*Global news media lacks women's perspective: Report*", publikuar në 11 dhjetor, 2020, shih: https://yourstory.com/herstory/2020/12/global-news-media-lack-womens-perspective-report/amp, qasur me 10.05.2021.

27 International Media Support: "*Women in media: Balance the imbalance!*", IMS, publikuar në mars, 2020, shih: *https://www.mediasupport.org/publication/women-in-media-balance-the-imbalance/#main-menu-toggle*, qasur me 10.05.2021.

vjetorin e Platformës së Veprimit të Pekinit të Kombeve të Bashkuara dhe përpara ka Projektin Global të Monitorimit të Medias 2020, bënë thirrje "për më shumë përpjekje dhe ndryshime në industrinë e medias që do të siguronin një portretizim të ekuilibruar dhe të drejtë të grave dhe burrave dhe të ofrojnë redaksi pa diskriminim dhe ngacmim për të gjithë. Gjithashtu, raporti citon rekomandimin Rec / CM (2013), i cili i inkurajon shtetet anëtare të mbështesin iniciativa dhe fushata të ndërgjegjësimit për luftimin e stereotipeve gjinorë në media"[28]

Raporti i mëhershëm i Agjencisë për Barazi Gjinore "Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011" tregon se brenda artikujve ku janë prezantuar gratë, mbi 22% janë në fushën e politikës, pasuar nga temat në fushën e kulturës (13%) dhe temat sociale (8.2%), kurse në fushën e sportit, prezantimi i grave është bërë më së shumti përmes promovimit të sukseseve të sportisteve (55.8%). Në anën tjetër, raporti vë në pah faktin se në kuadër të "kronikës së zezë", gratë më së shumti janë paraqitur në gazeta si viktima të dhunës në familje, apo në mbi 42% të rasteve. Në tërë materialin e analizuar, burrat citohen në rreth 70% të rasteve, ndërsa burrat dhe gratë citohen bashkërisht në të njëjtin artikull në 19% të rasteve"[29]

Po ashtu, raporti tjetër i publikuar nga Agjencia për Barazi Gjinore "Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2014 – 2015", thekson se Gratë në politikë është tema për të cilën ndahet më së shumti hapësirë në gazetat ditore në Kosovë, përkatësisht 28%. Pas saj, me radhë vjen hapësira e ndarë për tema që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave (17.4%), sportin (12.7%), kulturën (10.9%), jetën sociale (7.5%), gjyqësorin (4.6%), barazinë gjinore (4.1%), gratë e suksesshme (3%), shëndetësinë (2.7%), dhunën në familje (2.6%), ekonominë (2.1%), ekstremizmin fetar (1.8%), dhunën ndaj fëmijëve (1.3%), institucionet (0.9%) dhe korrupsionin (0.4%)"[30] Ndërsa, raporti nga Agjencia për Barazi Gjinore "Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2016 – 2019", thekson se po ashtu dominon fusha ose tema e politikës ose grave në politikë (vendore dhe ndërkombëtare) me 24.1%, pastaj sporti dhe kultura me nga 17.9% respektivisht 17.2%, dhuna ndaj grave 8.2%, jeta sociale 8.2%, barazi gjinore 7.0%, zgjedhjet 3.3%, shëndetësia, 2.7%, dhuna në familje dhe dhuna ndaj fëmijëve me nga 1.2%, temat në ekonomi me 1.3%, gratë e suksesshme 1.2%, gjyqësori me 1.2%, ekstremizmi fetar 1.2%, edukimi 1.1%, korrupsioni 0.8% dhe temat të cilat ndërlidhen me institucione 0.2%.

28 Council of Europe: *"Analytical Report Gender Equality Commission Steering Committee on Media and Information Society"*, Council of Europe, Strasbourg, July 2020, fq. 19-58.

29 Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: *"Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010 - 2011"*, ABGJ, Prishtinë, fq. 26.

30 Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: *"Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2014-2015"*, ABGJ, Prishtinë, fq. 19.

# 3. Analiza sasiore e materialit të mbledhur

## 3.1. Metodologjia e punës

Duke marrë parasysh specifikat e këtij hulumtimi, janë përdorur tri qasje metodologjike të hulumtimit: analizën sasiore, analizën cilësore, si dhe analizën e dokumenteve ekzistuese që kanë trajtuar fushën e barazisë gjinore. Kjo qasje metodologjike është marrë për bazë me qëllim të hulumtimit sa më reprezentativ të analizës, duke përdorur metodologji të kombinuara sasiore dhe cilësore. Gjatë viteve 2016-2019, ABGJ-ja ka mbledhur në baza ditore N=2,686 artikuj prej pesë gazetave ditore: *Kosova Sot, Koha Ditore, Bota Sot, Zëri dhe Epoka e Re*, të cilat janë analizuar nga ekipi hulumtues. Andaj, me qëllim të pasqyrimit sa më konciz dhe të drejtë të të dhënave, si pjesë e analizë sasiore, fillimisht është krijuar baza e të dhënave me kodime sipas kategorive, të cilat janë ndarë në tema të ndryshme, si: politikë, ekonomi, shëndetësi, gjyqësor, edukim, zgjedhje, barazi gjinore, kulturë, sport, etj. Përpunimi i këtyre të dhënave është bërë me programin e specializuar statistikor SPSS Nr. 24, i cili ka mundësuar analizën sasiore.

## 3.2. Gjetjet e analizës kryesore

Materiali i mbledhur nga ABGJ për vitet 2016 - 2019 me të gjithë artikujt që ka të bëjë me gratë e prezantuara në mediat e shkruara, ka shërbyer si bazë e këtij hulumtimi i cili përmban artikuj nga fusha të ndryshme, përfshirë: barazinë gjinore, gjyqësorin, gratë e suksesshme, shëndetësinë, politikën vendore dhe ndërkombëtare, edukimin, ekonominë, zgjedhjet, vendimmarrjen, kulturën, sportin, si dhe fusha të tjera relevante, të cilat përkojnë me natyrën e hulumtimit. Analiza ka pasur për bazë shqyrtimin e materialit të identifikuar në artikujt e gazetave ditore, përfshirë këtu: lajmet ditore, kolumnet dhe opinionet, përshkrimin e ngjarjeve nga vendi, rajoni dhe bota, storiet në kulturë, art, muzikë, letërsi dhe sport në vend dhe botë, pasqyrimin e dhunës në baza gjinore. Shkrimet dhe analizat e pasqyruara në këto gazeta, janë analizuar nga aspekti përmbajtjesor dhe vizuel, përfshirë sfondin e ballinës, fushës dhe brendësisë së gazetave.

Gjatë këtij hulumtimi, janë marrë parasysh Treguesit e Ndjeshëm Gjinorë për Media (GSIM) të UNESCO-s, *treguesi portretizimi gjinor në përmbajtjen e mediave, e cila përfshinë portretizimi gjinor në lajme dhe çështjet aktuale dhe portretizimi gjinor në reklama dhe publicitet* përkatësisht pesë objektivat

strategjike të prezantimit gjinor në përmbajtjen e mediave. UNESCO, në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Gazetarëve dhe shumë partnerë të tjerë, ka përpunuar këtë kornizë globale të Treguesve me Ndjeshmëri Gjinore për Mediat (TNGJM) [në anglisht: *Gender-Sensitive Indicators for Media* (GSIM)]. Kjo është pjesë e një sërë treguesish që po hartohen në të gjithë sektorët e organizatës për të mundësuar një vlerësim apo diagnozë efektive të fushave brenda mandatit të UNESCO-së për zhvillimin e mediave"[31]. Në kuadër të këtij dokumenti, UNESCO prezanton indikatorët/treguesit në dy kategori:

**Kategoria A**: Veprime për nxitjen e barazisë gjinore brenda organizatave të mediave, e cila përfshinë 5 objektiva: Balanca gjinore në nivelin e vendimmarrjes, Barazia gjinore në punë dhe kushtet e punës (së medieve), Barazia gjinore në organizata profesionale, shoqata, klube dhe bashkime të gazetarëve, profesionistëve të tjerë në fushën e mediave dhe në organet vetë-rregullatore të mediave, Organizatat e mediave promovojnë kode dhe politika etike në favor të barazisë gjinore në përmbajtjen e mediave dhe Balanca gjinore në arsim dhe aftësim profesional (të medieve).

**Kategoria B**: Portretizimi gjinor në përmbajtjen e mediave, e cila përfshinë Portretizimi gjinor në lajme dhe çështjet aktuale dhe Portretizimi gjinor në reklama dhe publicitet"[32].

Duke parë me kujdes të dy kategoritë e lartcekura të indikatorëve nga UNESCO, është bërë përpjekje për të analizuar materialin e prezantuar mbi bazën e këtyre treguesve, megjithëse disa nga indikatorët kanë qenë të pamundur të merren parasysh, për faktin se materiali i mbledhur gjatë fazës së monitorimit është fokusuar tërësisht në artikuj që kanë pasur të bëjnë kryesisht me gratë. Për këtë qëllim, është marrë për bazë vetëm kategoria e indikatorit B që ka të bëjë *portretizimin gjinor në përmbajtjen e mediave, e cila përfshinë portretizimi gjinor në lajme dhe çështjet aktuale dhe portretizimi gjinor në reklama dhe publicitet,* por jo edhe me kategorinë e parë që ka të bëjë me analizën e kompanive mediatike, stafit, trajnimeve, e të tjera.

31 UNESCO: *"Gender-Sensitive Indicators for Media – Framework of Indicators to Gauge Gender Sensitivity in Media Operations and Content"*, Paris, 2012, shih: https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000217831, qasur me datë 15.05.2021.

32 UNESCO: *"Gender-Sensitive Indicators for Media – Framework of Indicators to Gauge Gender Sensitivity in Media Operations and Content"*, Paris, 2012, shih: https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000217831, qasur me datë 15.05.2021.

Prandaj, artikujt me përmbajtje rreth pasqyrimit të burrave në mediat e shkruara nuk kanë qenë kriter i përzgjedhjes së artikujve të cilat janë pjesë e analizës dhe ato nuk janë përfshirë në materialin përfundimtar. Të dhënat e mëposhtme nuk paraqesin analizë krahasuese të prezantimit të grave kundrejt burrave, por analizojnë vetëm prezantimin e grave në kuadër të përmbajtjes së përgjithshme të gazetave ditore.

Në kuadër të kësaj analize, objektivat strategjik të indikatorëve të UNESCO-së të cilat kanë të bëjnë me prezantimin e balancuar dhe portretizimin e drejtë të burrave dhe grave në mediat (shtypura) nuk janë përfshirë në analizë. Mirëpo, ekipi hulumtues ka marrë parasysh objektivat tjera strategjike, të cilat përfshijnë:

1. Mbulimin e çështjeve të barazisë gjinore në lloje të ndryshme të përmbajtjes (raportime, komente, intervista, opinione, etj.), në fusha të ndryshme, si: barazinë gjinore, gjyqësorin, gratë e suksesshme, shëndetësinë, politikën vendore dhe ndërkombëtare, edukimin, ekonominë, zgjedhjet, vendimmarrjen, kulturën, sportin, si dhe fusha të tjera relevante, të publikuara në pjesë të ndryshme të shtypit ditorë;
2. Të dhëna mbi "*vetëdijen gjinore*" të paraqitur në lloje të ndryshme të përmbajtjes (raportime, komente, intervista, opinione, etj.), në fusha të ndryshme të paraqitura në media gjatë periudhës 2016 – 2019 nga materiali i mbledhur nga ABGJ; si dhe
3. Treguesit të cilët pasqyrojnë se si mediat e shkruara e kuptojnë dhe raportojnë në mënyrë të drejtë dhe të saktë mbi dhunën, pjesëmarrjen në vendimmarrjen, ekonomi, edukim, fuqizim të identitetit gjinor, reprezentimin në kulturë, art, film, sport në baza gjinore, etj.

**Grafikoni 1**: *Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë në mediat e shkruara gjatë vitit 2016 – 2019.*



Bazuar nga diagrami 1 shohim se është bërë krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë në mediat e shkruara. Këto të dhëna tregojnë se pasqyrimi i artikujve gjatë vitit 2016 – 2019 në mediat e shkruara mbulon hapësirën që iu është dhënë grave në medie. Në diagram, shohim se gazeta Koha ditore është gazeta e cila ka pasur më së shumti artikuj me rreth 38.5%, pastaj gazeta Bota Sot me gjithsej 23.2%, gazeta Zëri me 15%, pastaj Kosova Sot me 13.9% dhe në fund është edhe gazetën ditore Epoka e Re me gjithsej 9.4%.

Në mënyrë që të shohim më për së afërmi numrin e artikujve sipas gazetave ditore, janë pasqyruar të dhënat për gazetat në fjalë.

**Tabela 1**: *Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë sipas numrit dhe përqindjes së artikujve.*

| **Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë sipas numrit dhe përqindjes së artikujve** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Frequency | Percent | Valid Percent | Cumulative Percent |
| Valid | Kosova Sot | 374 | 13.9 | 13.9 | 13.9 |
| | Koha Ditore | 1035 | 38.5 | 38.5 | 52.5 |
| | Bota Sot | 623 | 23.2 | 23.2 | 75.7 |
| | Zëri | 402 | 15.0 | 15.0 | 90.6 |
| | Epoka e Re | 252 | 9.4 | 9.4 | 100.0 |
| | Total | 2686 | 100.0 | 100.0 | |

Në këtë tabelë shihet se janë pasqyruar 2,686 artikuj total sipas gazetave ditore, ku gazeta Koha Ditore ka pasur rreth 1,035 artikuj të ndryshëm, gazeta Bota Sot 623 artikuj, gazeta Zëri 402, gazeta Kosova Sot 374 dhe gazeta Epoka e Re 252 artikuj. Bazuar në këto të dhëna, shohim se gazeta Koha Ditore ka pasur artikuj që i është dhënë hapësirë më të madhe grave në raport me gazetat tjera ditore.

**Grafikoni 2**: *Hapësira e ndarë nga mediat e shkruara sipas temave.*




Diagrami i radhës pasqyron imazhin e temave të cilat janë paraqitur në mediat e shkruara, ku mund të shihet se dominon fusha ose tema e politikës ose grave në politikë (vendore dhe ndërkombëtare) me 24.1%, pastaj sporti dhe kultura me nga 17.9% respektivisht 17.2%, dhuna ndaj grave 8.2%, jeta sociale 8.2%, barazi gjinore 7.0%, tema kryesisht që trajtojnë drejtpërdrejtë përfaqësimin e barabartë gjinor në jetën publike dhe institucionale të grave, zgjedhjet 3.3%, shëndetësia, 2.7%, dhuna në familje dhe dhuna ndaj fëmijëve me nga 1.2%, temat në ekonomi me 1.3%, gratë e suksesshme 1.2%, gjyqësori me 1.2%, ekstremizmi fetar 1.2%, edukimi 1.1%, korrupsioni 0.8% dhe temat të cilat ndërlidhen me institucione 0.2%.

Të dhënat e paraqitura në kuadër të këtij diagrami, tregojnë se dominuese në mediat e shkruara gjatë vitit 2016 – 2019 kanë qenë kryesisht temat politike, në të cilat gratë kanë gjetur hapësirë më të madhe qoftë përmes titujve në ballinë apo edhe artikujve të ndryshëm të pasqyruara brenda gazetës. Ky fakt ka një korrelacion edhe me analizën e realizuar më parë nga Agjencia e Barazisë Gjinore për prezantimin e grave në mediat e shkruara për vitin 2014 – 2015, ku tema e grave në politikë ka qenë dominuese me 28%, gjë që tregon një sinjal se gratë në mediat e shkruara gjatë këtyre viteve janë paraqitur më shumë në hapësirat e politikës se sa në hapësirat tjera. Sido që të jetë, për dallim nga vitet e mëparshme, ku

analizat e kaluara kanë pasur më pak tema të potencuara, në këtë analizë janë të vendosura më shumë tema, andaj edhe përqindja e temës së grave në politikë është më e ulët për 6.1% se sa në vitin 2014-2015.

Tema e grave në politikë edhe pse trendi tregon se është tema kryesore në të cilën gratë kanë gjetur hapësirë në mediat e shkruara në Kosovë, kjo nuk nënkupton diskriminimin pozitiv apo negativ ndaj grave përmes artikujve e as ndonjë indikator për një rritje të mundshme mbi numrin e grave të cilat janë përfshirë në politikë krahasuar me vitet e mëparshme. Mirëpo, këto të dhëna tregojnë se përfshirja e grave në politikë ka një hapësirë më të madhe se sa temat tjera, për shkak se gazetarët kanë filluar që t'ju japinë hapësirë më të madhe grave, është rritur protagonizmi i grave politikane që ka sjellë edhe përfaqësim më të madh të grave në media, si dhe partitë politike kanë filluar t'ju japin hapësirë më të madhe grave, përfshirë pjesëmarrjen në pozita vendimmarrëse.

Lidhur me pasqyrimin e grave në mediat në fushën e zgjedhjeve, edhe pse në vitin 2019 janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, analiza pasqyron artikujt e grave lidhur me zgjedhjet edhe në vitet e kaluara. Tema e zgjedhjeve ka qenë prezentë edhe në vitet tjera, përfshirë vitin 2017 ku në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet lokale.

**Tabela 2**: *Hapësira e ndarë sipas temave në mediat e shkruara 2016 – 2019.*

| Ndarja në vite e hapësirës së gazetave ditore sipas temave | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Korrupsion | Institucion | Dhuna ndaj fëmijëve | Ekstremizmi fetar | Ekonomi | Dhuna në familje | Shëndetësi | Gratë e suksesshme | Barazi gjinore | Gjyqësor | Jeta sociale | Kulturë | Sport | Dhuna ndaj grave | Politikë | Edukim | Zgjedhjet |
| **2016** | 0.5 | 0.6 | 2.8 | 1.4 | 0.7 | 2.0 | 4.6 | 0.9 | 7.2 | 1.5 | 6.0 | 15 | 18.8 | 7.5 | 29.7 | 0.7 | 0.1 |
| **2017** | 0.9 | / | 3.3 | 1.4 | 3.3 | 0.7 | 2.4 | 0.5 | 7.8 | 2.1 | 12.5 | 17.6 | 17.4 | 6.8 | 21.9 | 1.2 | 0.2 |
| **2018** | 1.0 | / | 2.2 | 0.4 | 2.2 | 1.8 | 2.2 | 2.5 | 9.4 | 1.2 | 11 | 20.2 | 13.7 | 10.0 | 19.0 | 1.6 | 1.8 |
| **2019** | 0.9 | / | 0.9 | 1.5 | 0.5 | 3.5 | 0.5 | 0.9 | 4.6 | 0.4 | 6.6 | 18 | 19.8 | 8.8 | 21.1 | 1.4 | 10.4 |

Në kuadër të kësaj tabele, është krahasuar hapësira që u jepet temave të shkruara në vitet 2016 – 2019. Mund të shohim se gjatë këtyre viteve, hapësira më e madhe në 5 gazetat ditore të hulumtuara është ndarë për këto tema kryesore: tema e grave në politikë (në vitin 2016 ka qenë 29.7%, në vitin 2017 rreth 21.9%, në vitin 2018 rreth 19% dhe në vitin 2019 rreth 21.1%), sport (në vitin 2016 rreth 18.8%, në vitin 2017 rreth 17.4%, në vitin 2018 rreth 13.7% dhe në vitin 2019 rreth 19.8%), kulturë (në vitin 2016 rreth

15%, në vitin 2017 rreth 17.6%, në vitin 2018 rreth 20.2%, në vitin 2019 rreth 18%), dhuna ndaj grave (në vitin 2016 rreth 7.5%, në vitin 2017 rreth 6.8%, në vitin 2018 rreth 10% dhe në vitin 2019 rreth 8.8%).

Nëse bëjmë një analizë më të detajuar, del se hapësirat e ndara për temat në fjalë sipas viteve nuk është që kanë edhe dallime të mëdha, megjithëse temat e paraqitura në mediat e shtypura ndërlidhen ngushtë edhe me zhvillimin e ngjarjeve politike, ekonomike, sociale, kulturore, shëndetësore, e të tjera, të cilat kanë ndodhur gjatë viteve 2016-2019. Gjatë kësaj periudhe vërehet se dominojnë artikujt me përmbajtje të politikës, respektivisht grave në politikë dhe në vendimmarrje, për shkak në këtë periudhë e para e vendit ka qenë grua dhe zhvillimet e përgjithshme shoqërore janë ndërlidhur edhe më çështjet e sferës së politikës së brendshme dhe të jashtme siç janë edhe zhvillimi i dy palë zgjedhjeve, përkatësisht zgjedhjet lokale në vitin 2017 dhe ato të përgjithshme në vitin 2019.

**Grafikoni 3**: *Krahasimi i dy gazetave ditore për hapësirën e ndare sipas temave.*




Në këtë diagram pasqyrohet hapësira e ndarë për këto tema në dy gazetat ditore: Koha Ditore dhe Bota Sot, për vitet 2016 – 2019. Gazetat në fjalë janë zgjedhur për tu krahasuar pasi që gjatë këtyre viteve kanë ndarë hapësirë

më të madhe për gratë në krahasim me gazetat tjera dhe se gjatë fillimit të vitit 2019 gazetat tjera kanë filluar gradualisht nga shtypi i shkruar të transformohen në shtypin (median/portalet) elektronik. Nga këto të dhëna, vërehet se temat të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet e grave në politikë në Koha Ditore iu është dhënë hapësirë 20.2% kundrejt gazetës Bota Sot e cila ka pasur një hapësirë 30%. Në temën e sportit prin Koha Ditore për sa i përket ndarjes së hapësirës me 19.4% (sport) dhe 19.1% (kulturë) në raport me gazetën Bota Sot e cila të njëjta temave iu ka dhënë hapësirë 14.4% (sport) dhe 14.1% (kulturë). Ndërsa, lidhur me dhunën ndaj grave, vërehet se Bota Sot ka ndarë hapësirë rreth 12.2% në raport me Kohën Ditore e cila ka ndarë hapësirë për të njëjtën temë rreth 8.1%.

Sikurse edhe në hulumtimet e mëparshme të cilat janë realizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore, edhe gjatë këtij hulumtimi është vërejtur se gazetat në përgjithësi më shumë i kanë kushtuar rëndësi sasisë së artikujve, në veçanti tek temat/kronikat të cilat ndërlidhen me dhunën ndaj gruas Një trend i tillë ka përcjellë mediat e shkruara edhe gjatë viteve 2016 – 2019. Kjo vërehet në përgjithësi në artikujt që kanë të bëjnë me dhunën në familje, përkatësisht dhunën ndaj gruas, por edhe në format tjera të dhunës siç janë: rastet e tentim vrasjeve dhe vrasjeve, abuzimi seksual, e të tjera. Artikujt kryesisht janë paraqitur në '*kronikat e zeza*', duke shfrytëzuar informacionet nga institucionet zyrtare siç janë: policia dhe prokuroria e shtetit. Trajtimi i këtyre rasteve në artikujt e paraqitur në gazetat ditore '*kronikat e zeza*', kryesisht kanë qenë përshkrim i rastit, duke përdorur një numër relativisht të vogël të burimeve dhe nuk janë shfrytëzuar hulumtime më të gjera të cilat artikujt do t'i bënin cilësisht më të mira.

Në këto raste mungojnë shpeshherë analizat më të gjera dhe konsultimet me profesionistët e fushës siç janë: mjekët, psikologët, sociologët, qendrat për punë sociale, organizatat e ndryshme jo qeveritare, si dhe akterë të tjerë, të cilët do të ndihmonin në kualitetin më të mirë të artikullit. Madje, në disa artikuj zë hapësirë më të madhe fotografia simbolike ndaj dhunës ndaj grave se sa që artikujt fokusohen në sfondin e perspektivës gjinore dhe të analizës, si dhe në shumë raste informacionet e ofruara janë më shumë përshkruese se sa informacion adekuatë. Madje, shërbimet që ofron shteti apo OJQ-të për të drejtat e garantuara apo edhe ndonjë mundësi për fuqizim ekonomik të viktimave të dhunës të cilat në mungesë të mbështetjes financiare mbesin në ciklin e dhunës. Artikuj me shembuj të tillë janë pasqyruar në pjesën e dytë të kësaj analize.

**Grafikoni 4**: *Hapësira e politikës e ndarë në tema.*




Diagrami 5 pasqyron hapësirën e politikës të ndarë në tema, ku vërehet pjesa më e madhe e temave ndërlidhen me gratë në politikë ose shprehur në përqindje 49.1%, pastaj gratë në politikë/botë 39.1%, pasuar nga temat të cilat ndërlidhen me gratë në vendimmarrje me një përqindje prej 7.8% dhe vendimmarrja ose gratë në vendimmarrje në botë me 4.1%. Gjatë analizës së artikujve, është vërejtur se pjesa më e madhe e artikujve bazohen në citimet drejtpërdrejta të akterëve të temave. Po ashtu, paraqitja e akterëve përmes fotografive është vërejtur se është korrekte dhe në pajtim me natyrën e temës specifike të shtjelluar në artikull.

Ajo që shpeshherë bie në sy në këto artikuj, është fakti që artikujt në fushën e grave në politikë lidhen me pozicionin e grave në pozita vendimmarrëse, siç është rasti me: Presidenten Jahjaga, zëvendëskryeministren Edita Tahiri, kryetaren e Gjykatës Kushtetuese Arta Rama – Hajrizi, kryetaren e KQZ-së Valdete Daka, kryetaren e komunës së Gjakovës Mimoza Kusari Lila, e të tjera, si dhe aktivitetin e grave në politikë siç është rasti me: Vjosa Osmani, Besa Gaxherri, Hikmete Bajrami, Albulena Haxhiu, Donika Kada – Bujupi, e të tjera.

Në rastin e artikujve që trajtojnë gratë në politikë në nivel botërorë, artikujt më shumë flasin për pushtetin e tyre vendimmarrës dhe ndikimin që kanë

në politikbërjen e brendshme dhe raportet në politikën e jashtme. Në këtë segment, shohim se artikujt lidhen shpeshherë me vendimmarrjen dhe fuqinë e shteteve me më ndikim në botë siç janë: ish kryeministrja Theresa May, Hillary Clinton, Kancelarja Angela Merkel, e të tjerë. Ndërsa, në rastin e Kosovës, vërehet se artikujt e paraqitjes së grave në politikë dhe vendimmarrje ndërlidhen me kontekstin kulturor dhe politikë të vendit, si dhe pozicionin institucional që ushtrojnë ato. Në shumicën e rasteve, artikujt të cilët iu referohen grave në politikën kosovare, i atribuohen më shumë vendimeve formale se sa ndikimit që mund të kenë në ndryshimet shoqërore.

**Tabela 3**: *Hapësira e politikës e ndarë në tema sipas gazetave ditore 2016-2019.*

| **Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë * Hapësira e politikës e ndarë në tema** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vendimmarrje / Botë | Gratë në politikë / Botë | Gratë në politikë | Gratë në vendimmarrje | Totali |
| Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë | Koha Ditore | 48.3% | 43.3% | 21.3% | 20.0% | 30.9% |
| | Bota Sot | 20.7% | 22.0% | 38.8% | 23.6% | 30.3% |
| | Zëri | 20.7% | 10.8% | 14.7% | 18.2% | 13.7% |
| | Epoka e Re | 3.4% | 6.9% | 17.5% | 34.5% | 14.1% |
| | Kosova Sot | 6.9% | 17.0% | 7.8% | 3.6% | 11.0% |
| Total | | 100.0% | 100.0% | 100.0% | 100.0% | 100.0% |

Tabela pasqyron kryqëzimin në mes të gazetave dhe temave të pasqyruara në sfondin e artikujve që të kanë të bëjnë me gratë në politikë. Kësisoj, gazeta Koha Ditore, vërehet se vendimmarrjes së grave në botë i ka kushtuar hapësirë rreth 48.3%, grave në politikë në nivel global 43.3%, grave në politikë në vend 21.3% dhe grave në vendimmarrje në vend rreth 20%. Gazeta e radhës ka qenë gazeta Bota Sot e cila në fushën e vendimmarrjes së grave në botë ka pasur hapësirë 20.7%, gratë në politikë në botë 22%, gratë në politikë (në nivel vendi) 38.8% dhe gratë në vendimmarrje 23.6%. Gazeta Zëri në temat rreth grave në vendimmarrje në botë ka pasur një hapësirë prej 20.7%, gratë në politikë në botë ka pasur më pak hapësirë se gazetat tjera me 10.8%, gratë në politikë në nivel vendi 14.7% dhe gratë në vendimmarrje 18.2%. Gazeta Epoka e Re e cila në temat që kanë të bëjnë më vendimmarrjen e grave në botë ka pasur një hapësirë 3.4%, gratë në politikë në botë 6.9%, gratë në politikë në vend 17.5% dhe shohim se tek temat që kanë të bëjnë me gratë në vendimmarrje ka pasur një hapësirë më të madhe se sa gazetat tjera me gjithsej 34.5%. Në fund, është edhe gazeta

Kosova Sot e cila ka ndarë hapësirë për gratë në vendimmarrje në botë 6.9%, në gratë në politikë në botë 17%, gratë në politikë 7.8% dhe gratë në vendimmarrje 3.6%.

Në pjesën më të madhe të artikujve vërehet që mediat e shkruara kanë dhënë hapësirë grave në fushën e politikës dhe vendimmarrjes në vend dhe jashtë vendit, sidomos në rastet kur zhvillimi i ngjarjeve ka determinuar përfshirjen më të gjerë të akterëve të ndryshëm. Kjo lë të kuptohet se artikujt kryesisht janë fokusuar në ngjarjet e politikës ditore dhe zhvillimet të cilat kanë përfshirë vendin në ngjarjet politike brenda dhe jashtë. Vërehet se gazetat të cilat i kanë kushtuar më shumë hapësirë grave në politikë dhe vendimmarrje janë: Koha Ditore dhe Bota Sot, të cilat në një ose tjetrën mënyrë përmes artikujve të pasqyruar kanë përkrahur gratë.

**Grafikoni 5**: *Pasqyrimi i dhunës ndaj grave sipas temave në mediat e shkruara.*




Pasqyrimi i dhunës sipas temave, gazetat ditore hapësirë më të madhe i kanë ndarë: dhunës në baza gjinore 29.6% që është hapësirë më e ulët se sa artikujt e vitit 2014-2015 që ishte 39.6%, pastaj hapësira e temave rreth vrasjes 20.8%, diskriminimi gjinor 13.0%, trafikimi/prostitucioni 9.4%, të tjera 9.1% është një përqindje relativisht e madhe, pasi që janë përfshirë kategoritë e ndryshme, siç janë: vetëvrasjet, abuzimet seksuale, kërcënimet, etj, dhuna seksuale gjatë luftës 5.5%, ngacmimi seksual në

institucione 2.8, përkujdesje institucionale për të dhunuarat gjatë luftës 2.5%, viktima të luftës 2.5%, vjedhje 2.5%, rrëmbim 1.9% dhe tentim vrasje 0.3%.

Gjatë këtij hulumtimi janë vërejtur dukshëm temat (artikujt) të cilat lidhen më dhunën në baza gjinore dhe me fenomenin e tentim vrasjeve dhe vrasjeve ndaj grave. Bazuar në fushën e dhunës ndaj grave sipas temave, vërehet se përshkrimi i rasteve në këto artikuj është shumë-dimensional. Artikujt flasin jo vetëm për çështjen e vrasjeve të grave në Kosovë, por edhe për proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me rastet e tilla, protestat dhe aktivitetet e ndryshme. Gjithashtu, artikujt flasin edhe për hapat të cilat janë ndërmarrë nga institucionet e vendit dhe shoqëria civile për një aktivizim qytetarë për të ngritur vetëdijen e përgjithshme shoqërore për parandalimin dhe trajtimin e këtyre rasteve.

Në kuadër të sportit dhe kulturës, si tema të rëndësishme të cilat kanë përcjellë shoqërinë kosovare gjatë këtyre viteve. Artikujt që kanë të bëjnë me këto tema dhe janë pasqyruar si vijon:

**Grafikoni 6**: *Hapësira e ndarë për gratë në sport.*




Diagrami 6 pasqyron artikujt e gazetave të ndara për gratë në sport, ku vërehet se mbi 53.3% e artikujve fokus gjatë kësaj periudhe kanë pasur xhudon kosovare. Artikuj të tjerë të cilat kanë dominuar hapësirat

e gazetave janë: gratë në sporte tjera me 12.9%, gratë në sport në nivel botëror me 9.2%, në futboll 8.3%, në volejboll 5%, në basketboll me 5%, pastaj gratë në hendboll 3.1%, gratë në boks 2.5 dhe gratë në not 0.6%

Fakti që mediat e shkruara i kanë kushtuar rëndësi më së shumti artikujve për gratë në sport të xhudos, ndërlidhen me sukseset e xhudisteve kosovare Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria dhe Leutrime Krasniqi në arenën ndërkombëtare, sidomos Majlinda Kelmendi e cila në vitin 2016 u shpallë edhe kampione olimpike"[33] ka ndikuar që gazetat të kenë një vëmendje më të madhe ndaj këtij sporti, duke i paraqitur xhudistet kosovare jo vetëm në hapësirën e rezervuar ekskluzivisht për sport, por edhe në ballinat e gazetave. Pjesa më e madhe e artikujve në këtë fushë më shumë i atribuohen këtij sporti si përshkrues se sa analitik ose motiv psikologjik për gratë që të gjejnë vetën e tyre në këtë sport ose edhe në sporte tjera luftarake të cilat sterieotipizohen si '*sporte maskuliniste*'. Megjithëse, në anën tjetër edhe vetë fakti i masivizimit të këtij sporti sidomos pas vitit 2012 e këtej ka qenë edhe një lloj ngritje e vetëdijes shoqërore dhe inkurajim, në veçanti ndaj vajzave të reja që të merren me aktivitete sportive të cilat ndikojnë në shëndetin e tyre, si dhe kanë hapësirë të shfaqin shkathtësitë e tyre.

Gjithashtu, nuk kanë munguar as temat të cilat ndërlidhen me sportet tjera dhe sukseset e sportisteve kosovare përfshirë bokserën Donjeta Sadiku, notaren Rita Zeqiri, e kështu me radhë.

**Grafikoni 7**: *Hapësira e ndarë për gratë në kulturë.*




33 https://www.judoinside.com/judoka/42942/Majlinda_Kelmendi/judo-career, qasur me datë 15.05.2021.

Hapësira e ndarë për gratë në kulturë, po ashtu ka zënë vend edhe gjatë viteve 2016 – 2019. Në këtë drejtim, vërehet se gratë në art zënë hapësirë me temat e artikujve me 32.8%, gratë në muzikë, 29.7%, gratë në kulturë në nivel botërorë me 14.5%, në film me 12.1%, në letërsi me 8% dhe kontribut i grave me 2.8%, që kanë të bëjnë më shumë me kontributin e grave në sferat e ndryshme kulturore, ndërtimin e urave lidhëse në mes të kulturave dhe kontributin e grave në paraqitjen dhe promovimin në ngjarjet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Gratë në art dhe në muzikë si: Rita Ora, Dua Lipa, Bebe Rexha, Era Istrefi, Ana Oksa, sopranoja Inva Mula e të tjera kanë qenë vetëm disa nga ikonat shqiptare të cilat kanë zënë hapësira në mediat e shkruara gjatë kësaj periudhe. Paraqitja e tyre në ngjarjet e mëdha botërore, fitimi i çmimeve ndërkombëtare në muzikë siç është rasti me Dua Lipën, organizimi i festivaleve në Prishtinë me karakter ndërkombëtar si 'Sunny Hill'[34], pjesëmarrja e Rita Orës në përvjetorin e pavarësisë së Kosovës, pjesëmarrja e Era Istrefit në ngjarjen e hapjes zyrtare të fillimit të kampionatit botëror në Rusi[35], krahas emrave të skenës ndërkombëtare, si Ëill Smith dhe Nicky Jam, janë disa nga narracionet e artikujve që kanë pasur fokus këto ngjarje.

Artikujt të cilët kanë të bëjnë me temat e grave në film si: Arta Dobroshi, Yllka Gashi, e të tjera po ashtu kanë zënë hapësira të konsiderueshme, të cilat lidhet me pjesëmarrjen në festivaleve të mëdha botërore dhe fitimin e çmimeve ndërkombëtare në këtë fushë, që dëshmojnë për kontributin enorm që gratë kosovare e kanë dëshmuar në fushën e artit, kinematografisë dhe rezultatet e tyre kanë zënë hapësirë në prezantim të konsiderueshëm në media. Suksesi i tyre në një mënyrë imponoi edhe hapësirën mediatike që ju ofrua.

Hapësirë të konsiderueshme kanë zënë edhe gratë në letërsi përmes botimit të librave në profile të ndryshme (poezi, prozë, dramë, romane, etj), si dhe nxitjes së diskursit kritik mbi letërsinë.

Vërehet se një pjesë e konsiderueshme e artikujve në kuadër të këtyre temave, më shumë përshkruhen si një lloj informate se sa që shtjellohen si model për vajzat dhe gratë tjera ose inkurajim që të shfaqin talentin e tyre në skenën vendore dhe atë ndërkombëtare. Fotografitë kryesisht janë foto të cilat ndërlidhen me akterët në fjalë, por që rrallë ose fare paraqitën në ballina, ato paraqitën më shumë në hapësirën e kulturës. Gjithashtu, në disa artikuj të tjerë, vërehet përshkrimi pozitiv i paraqitjes së grave në

34 https://sunnyhillfestival.com/, qasur me 18.06.2021.

35 https://www.kultplus.com/muzika/era-istrefi-ngjitet-ne-skenen-e-madhe-te-kampionatit-boteror-ne-rusi-foto/, qasur me 18.06.2021.

kulturë, art, muzikë dhe film, e cila tregon paraqitjen e saktë të ngjarjeve duke i paraqitur ngjarjet jo vetëm në kontekstin përshkrues, por edhe elaborues me intervista, kronika nga vendi i ngjarjes, me çka ka bërë që artikujt të pasqyrojnë saktë ngjarjen dhe të shërbejnë si inkurajim për gratë tjera.

Gazeta e cila më së shumti i ka kushtuar hapësirë grave në temat e kulturës është: Koha Ditore me 38.5%, Bota Sot 23.2%, Zëri 15%, Kosova Sot 13.9% dhe gazeta Epoka e Re 9.4%.

**Grafikoni 8**: *Hapësira e ndarë për gratë në shëndetësi*




Lidhur me temat e shëndetësisë, shohim se gazetat ditore hapësirë më të madhe i kanë dhënë shëndetit të fëmijëve me 27.4%, shëndeti riprodhues i grave me 22.6%, shëndeti grave me 19%, shëndeti nga pikëpamja institucionale me 13.1%, moskujdesi institucional ndaj grave me 9.5%, shëndeti i grave në nivel botëror me 7.1% dhe shëndeti mendor 1.2%.

Shëndeti i fëmijëve, zë hapësirë më të madhe në raport me temat tjera në këtë fushë, për shkak të kërkesës dhe ndjeshmërisë më të madhe që ka në shoqëri. Prezantimi është dukshëm i fokusuar më shumë në fushata sensibilizuese për shëndetin e fëmijëve, shëndetin e gruas dhe shëndetin riprodhues të grave, fushata këto të cilat ndikojnë në shëndetin e përgjithshëm, si dhe në mirëqenien e plotë fizike, mendore dhe sociale. Sa i përket shëndetit nga

pikëpamje institucionale, artikujt janë fokusuar në përshkrimin e rasteve të (mos) kujdesit institucional dhe zhvillimin e problematikës së shëndetit. Në aspektin e kujdesit institucional, temat janë fokusuar në vetëdijesimin për rreziqet nga sëmundjet e ndryshme, përfshirë kancerin e gjirin, pastaj ekipet mobile në terren për mamografinë, sëmundjet kronike, e të tjera. Kjo lë të kuptohet se ka një hapë cilësor në hapësirën që mediat i ofruan për çështje të shëndetit seksual dhe riprodhues, çështjeve që janë të rëndësisë kruciale për një jetë të shëndetshme të mirëqenies shëndetësore së grave dhe vajzave.

Ndërsa, në aspektin e moskujdesit institucional ndaj grave, disa raste janë lidhur me neglizhencën apo mos ofrimin e ndihmës adekuate ndaj grave. Shëndeti mendor është pasqyruar me fokus në problematikat psikologjike siç është: stresi, depresioni, ankthi, e të tjera, të cilat ndikojnë në jetën e përditshme. Kurse, fusha që ka të bëjë me shëndetin e grave në botë ka përfshirë trajtimin e shëndetit të përgjithshëm të gruas në vendet e ndryshme në botë.

Në përgjithësi trajtimi i këtyre temave është pjesë e rëndësishme redaktoriale e gazetave ditore dhe vërehet se një mbulueshmëri më e madhe të artikujve në këtë fushë. Sa i përket profesionalizmit dhe trajtimit etik të ngjarjeve, artikujt kryesisht trajtohen në nivel profesional dhe etik.

**Grafikoni 9**: *Hapësira e ndarë për tema për barazinë gjinore.*



Në kuadër të hapësirë së ndarë për temat e barazisë gjinore në mediat e shkruara, vërejmë se temat të cilat kanë dominuar gjatë kësaj periudhe kanë qenë temat: fuqizimi i gruas me 40.4%, gratë dhe feja 19.1%, diskriminimi gjinor 12%, edukimi 9.7%, të drejtat pronësore 6%, të drejtat e grave 5.2%, identiteti gjinor 3.7%, të tjera 2.2% dhe diskriminimi gjinor në botë 1.5%.

Fuqizimi i gruas si kategori e rëndësishme e temave të trajtuar në artikujt e gazetave ditore, ka gjetur hapësirë relativisht të madhe, edhe për faktin e zhvillimit të aktiviteteve të shumta shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike. Gratë dhe feja po ashtu ka qenë temë e cila ka zë hapësirë në mediat e shkruara, për shkak të zhvillimeve vendore dhe ndërkombëtare në fushën e lëvizjeve të ndryshme fetare. Sa i përket diskriminimit gjinor, artikujt trajtojnë temat në fushën e diskriminimit gjinor dhe pengesat që hasin gratë për pjesëmarrje të barabartë në jetën shoqërore. Tema përafërsisht të njëjta janë trajtuar përmes artikujve edhe në kuadër të diskriminimit gjinor në botë.

Edukimi si element thelbësor i emancipimit shoqëror, po ashtu ka pasur hapësirë të konsiderueshme në gazeta. Gratë në këtë fushë janë paraqitur me aktivitetet e tyre, duke përfshirë mësimdhënien, edukimin e të rinjve, trajnimet e ndryshme, emancipimin dhe pjesëmarrjen e grave në aktivitetet shkencore dhe akademike. Të drejtat pronësore dhe të drejtat e grave, kanë pasur hapësirë në artikujt e paraqitur në këtë periudhë, për shkak të masave afirmative të institucioneve dhe mekanizmave tjerë për të drejtat e grave dhe të pronës në përgjithësi. Për arsye të problematikës dhe mendësisë partiarkale të trajtimit të pronës, në Kosovë ende mbetet problem trashëgimi i barabartë i pronës. Kjo ka përfshirë ndryshimet e legjislacionit për barazi gjinore, pronës, trashëgimisë, etj, si dhe inkurajimin për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve. Identiteti gjinor, gjithashtu ka pasur hapësirë në artikujt e gazetave, ku janë përfshirë çështje të cilat lidhen me përshkrimin gjinor të gruas, komunitetin LGBTI, të drejtat e tyre e kështu me radhë.

Fakti që mediat e shkruara hapësirë i kanë dedikuar temave që kanë të bëjnë me fuqizimin e gruas ka të bëjë me periudhën e zgjedhjeve në Kosovë të cilat ishin në vitin 2019, përkatësisht hapësira që partitë politike iu kanë dhënë grave, pastaj paraqitja e këngëtareve dhe sportisteve nga Kosova në arenën ndërkombëtare dhe rezultatet e tyre, avokimi institucional dhe i

organizatave të shoqërisë civile lidhur me të drejtat e grave dhe promovimi i tyre, zhvillimi i kuadrit ligjor, e të tjera janë disa nga faktorë që kanë ndikuar në hapësirën më të madhe që kanë zënë temat rreth fuqizimit të grave.

Ndërmarrja e hapave afirmativ dhe përmirësimi i kornizave ligjore dhe politikave zhvillimore përmes qasjes së integruar gjinore nga institucionet shtetërore, avokimi dhe iniciativat mbështetëse nga organizatat joqeveritare kanë kontribuar në rritjen e profilit të grave në të gjitha fushat politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Ky profil në rritje është imponuar edhe ndaj përmbajtjes së informacionit mediatik e po ashtu edhe në prezantimin e profileve gjinore dhe çështjeve gjinore, si prezantim numerik në faqet e gazetave dhe jo vetëm.

Po ashtu, paraqitja dhe suksesi i grave në fushën e sportit, muzikës, artit, kulturës, filmit, e të tjera, ka bërë që në mënyrë indirekte të ndikoj që mediat t'ju japin hapësirë më të madhe grave se sa në të kaluarën, duke përfshirë këtu edhe hapësirën për gratë që kanë pasur aktivitete më të vogla në fushën publike. Normalisht që ky fakt më shumë ka të bëjë me paraqitjen sasiore se sa cilësore, kjo për shkak se analiza e storieve të suksesit kryesisht mungon.

Sa i përket temave të cilat ndërlidhen me hapësirën e dedikuar për gratë dhe fenë, është vërejtur që këto tema kanë dominuar gjatë kësaj periudhe, për shkak edhe të zhvillimeve ndërkombëtare. Zhvillimi i konflikteve në Lindjen e Mesme e që lidhet drejtpërdrejt edhe me pjesëmarrjen e qytetarëve të Kosovës në këto konflikte, pastaj edhe implikimi direkt i grave në këto konflikte, megjithëse vlen të theksohet se "asnjë nga gratë nga Kosova nuk ka emigruar në Siri dhe Irak vetëm, por të shoqëruara nga bashkëshortët dhe familjet e tyre"[36], por edhe angazhimi vendor dhe ndërkombëtar në parandalimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto konflikte, ka bërë që këto tema të gjejnë hapësirë të madhe në mediat e shkruara. Kjo do të thotë se gratë nga Kosova, nën presionin e burrave të tyre janë nisur për në konfliktet e Irakut dhe të Sirisë, jo si zgjidhje personale të tyre. Gjithashtu, ndoshta kjo është një alarm për shoqërinë kosovare dhe mediat se sa e rëndësishme është ngritja e vetëdijes se grave, vajzave dhe institucioneve për të hartuar politika parandaluese që gratë të mos bien pre e burrave që

36 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë: "*Gratë në Ekstremizmin e Dhunshëm - Mësimet e nxjerra nga Kosova*", QKSS, Prishtinë, fq. 21, http://www.qkss.org/repository/docs/women-in-ve-alb_(2)_384205.pdf

duan t'i përfshijnë ato në luftëra të huaja (fetare) dhe që dëmtojnë gratë dhe fëmijët në mënyrë të drejtpërdrejtë.

**Grafikoni 10**: *Hapësira e ndarë për gratë në ekonomi.*




Në hapësirën e ndarë për gratë në ekonomi nga gazetat ditore, vërejmë se temat të cilat kanë zënë hapësirë më të madhe janë gratë dhe punësimi 35.3%, gratë në ekonomi 20.6%, gratë ndërmarrëse 17.6%, vendimmarrja 17.6% dhe tema të tjera 8.8%.

Gjatë kësaj periudhe 2016 – 2019 hapësira e dedikuar për gratë dhe punësimi në mediat e shkruara, ka qenë ndër temat që ka zënë hapësirë të konsiderueshme në mediat e shkruara. Një gjë e tillë ka të bëjë me faktin e mbështetjes së grave në krijimin e vendeve të punës përmes start up-eve, si dhe zhvillimeve të tjera në këtë fushë. Po ashtu, gratë në ekonomi, ndërmarrësi dhe vendimmarrje, janë tema të cilat kanë zënë hapësirë të konsiderueshme dhe të cilat ndërlidhen edhe me zhvillimin e politikave dhe programeve institucionale, programeve nga organizatat ndërkombëtare dhe nga organizatat e shoqërisë civile.

Artikujt kanë trajtuar aktivitetet e ndryshme të grave në sferën e ekonomisë dhe ndërmarrësisë, me mbështetjen e mekanizmave vendor

dhe ndërkombëtar për zhvillim ekonomik, fuqizim të gruas, ndërmarrësi, punësim dhe zhvillim shoqëror në përgjithësi. Ky fakt tregon për rolin dhe suksesin e grave në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në vend, duke i maksimalizuar mundësitë e ofruara nga mekanizmat e ndryshëm institucional, të cilat kanë senzibilizuar opinionin për rëndësinë e krijimit të mundësive të reja për punësimin e grave nisur nga fakti se gratë kosovare janë të nën përfaqësuara në tregun e punës dhe mos integrimi i tyre në punësim do të thotë edhe ngecje në zhvillimin ekonomik të vendit.

# 4. Analiza Kritike e Diskursit dhe Analiza Semiotike Multimodale

## 4.1. Analiza sasiore e materialit të mbledhur

Në kuadër të analizës cilësore të materialit të mbledhur, hulumtimi do të bazohet në dy metoda kryesore:

a) Analizën Semiotike Multimodale;
b) Analizën Kritike të Diskursit.

Të dy metodologjitë në fakt kanë një ndërlidhje në mes vete dhe shpeshherë përdoren për qëllim të analizës së tekstit, përmbajtjes, zhanrit, sfondin të shkronjave, analizës dhe dimensioneve të fotove, e të tjera. Diskursi mediatik i "referohet ndërveprimeve që ndodhin përmes një platforme transmetimi, qoftë të folur apo e shkruar, në të cilën diskursi është i orientuar tek një lexues, dëgjues ose shikues jo prezent. Megjithëse diskursi është i orientuar drejt këtyre marrësve, ata shumë shpesh nuk mund të bëjnë përgjigje të menjëhershme ndaj prodhuesit (ve) të diskursit. Diskursi i shkruar ose i folur në vetvete është i orientuar drejt audiencës së lexuesve, respektivisht dëgjimit / shikimit. Me fjalë të tjera, diskursi mediatik është një formë e ndërveprimit publik, i prodhuar dhe i regjistruar"[37].

Analiza semiotike multimodale i referohet procesit të interpretimit dhe kuptimit të të dhënave cilësore në projekte të ndryshme që ngërthejnë forma verbale dhe joverbale të informacionit. Është një metodologji e gjerë që përfshinë: analizën e komunikimit jo verbal, imazhet, videot, tingujt dhe materialet 3-D, të cilat tashmë janë shndërruar në një inovacion të ri në sferën teknologjike. Sipas Van Leeuëen (2005) multimodaliti "nënkupton ndërthurjen e mënyrave të ndryshme semiotike - për shembull, gjuha dhe muzika - në një artefakt komunikues ose në një ngjarje. Një përkufizim më specifik është se diskursi multimodal (në rastin e këtij hulumtimi teksti i shkruar si produkt mediatk, për dallim nga muzika përfshinë gjuhën dhe foton) përfshin ndërveprimin e burimeve të shumta semiotike si: gjuha, gjestet, veshja, arkitektura, ndriçimi i afërsisë, lëvizja, vështrimi, këndi i kamerës, etj"[38].

37 O'Keeffe, Anne: "*Media and discourse analysis*", shih: https://dspace.mic.ul.ie/bitstream/handle/10395/1681/O%20?sequence=2, qasur më 20.06.2021.

38 Yang Yang: "*A social Semiotic Approach to Multimodal Discourse of the Badge of Xi' and Jiaotong University*", Theory and Practice in Language Studies, Vol. 6, No. 8, pp. 1596-1601, August 2016, fq. 1-2.

Kjo lë të kuptohet se në analizën semiotike multimodale, "analiza dhe interpretimi i përdorimit të gjuhës kontekstualizohet së bashku me burimet e tjera semiotike, të cilat përdoren njëkohësisht për ndërtimin e kuptimit. Për shembull, përveç zgjedhjeve gjuhësore dhe instancat të tyre tipografike në faqen e shtypur, analiza multimodale merr parasysh funksionet dhe kuptimin e imazheve vizuale, së bashku me kuptimin që buron nga përdorimi i integruar i dy burimeve semiotike"[39].

Ndërsa, analiza kritike e diskursit, "është një qasje metodologjike për analizën e gjuhës në mënyrë që të shqyrtohen problemet sociale, me një fokus problemet në pushtet, veçanërisht çështjet rreth abuzimeve të pushtetit duke përfshirë diskriminimin dhe mos-fuqizimin. Analiza e konsideron gjuhën në tekste, por edhe tekstet në lidhje me kontekstin më të gjerë shoqëror në të cilin ato prodhohen dhe merren. Van Dijk dhe të tjerët (1991) argumentojnë se gazetat ndikojnë në opinionin publik, ndërsa Gerbner et al. (1986) pretendojnë se efekti i medias në një audiencë përbëhet (zhvillohet) me kalimin e kohës për shkak të përsëritjes së imazheve dhe koncepteve"[40]. Në mënyrë më specifike, analiza e diskursit fokusohet në strukturën e tekstit, strategjisë, cilësisë, vetive tjera, bisedës ose ngjarjeve komunikuese të cilat luajnë një rol me rëndësi në mënyrën e realizimit të një artikulli ose teksti. Pra, përderisa analiza e diskursit fokusohet në kontekstin social në të cilën realizohet një artikull (tekst), analiza semiotike multimodale ka fokus më shumë faktin se si një artikull i shërbehet lexuesit.

Analiza kritike e diskursit e njohur si '*CDA*' është "një lloj i hulumtimit analitik i diskursit që kryesisht studion dhe analizon mënyrën se si dominimi, abuzimi dhe pabarazia e pushtetit shoqëror miratohet, riprodhohet dhe rezistohet nga teksti dhe bisedat në kontekstin social dhe politik. Përmes një hulumtimi të tillë të pavarur, analistët e diskursit kritik kanë një pasqyrë më të qartë mbi kuptimin, ekspozimin dhe rezistimin ndaj pabarazive sociale në shoqëri"[41]. Vlerat e përgjithshme të analizës së diskursit kritik "kanë një ndërlidhje në mes të qasjeve njohëse dhe socio – kritike, të cilat fokusohen në:

39 Çoşkun, Gül Esra: "*Use of Multimodal Critical Discouse Analysis in Media Studies*", The Online Journal of Communication and Media – July 2015, Volume 1, Issue 3, fq. 41.

40 Baker, Paul and McGlashan, Mark: "*Critical Discourse Analysis*", Baker, P. & McGlashan, M. (2020) 'Critical Discourse Analysis'. In: Adolphs, S. & Knight, D. (Eds.) The Routledge Handbook of English Language and the Digital Humanities. London: Routledge, fq. 2-3.

41 Ali, Azkiya, Fariza: "*Some Fundamental Theories of Critical Discourse*", Department of English, Faculty of Teachers Training and Education, University of Lancang Kuning, fq .2.

- Diskursin që e përbën shoqërinë dhe kulturën në një marrëdhënie dialektike;
- Analiza kritike e diskursit adreson problemet sociale;
- Ka një lidhje midis tekstit dhe shoqërisë që ndërmjetësohet përmes diskursit;
- Diskursi është një formë e veprimit shoqëror”[42].

Për këtë qëllim, në këtë pjesë janë përdorur dy metoda për analizimin e artikujve të mbledhur, të cilat kanë shpjeguar aspektet e përgjithshme të prezantimit të grave në fusha të ndryshme shoqërore. Andaj, ndërveprimi mes tekstit të shkruar, imazheve dhe elementeve tjera grafike e vizuale në kuadër të artikujve të pasqyruar janë të rëndësishme për zhvillimin e një analize të tillë kritike. Duke parë rolin dhe rëndësinë që mediat kanë në shoqërinë kosovare, hulumtimi është fokusuar në analizën kritike të artikujve të botuar në gazetat ditore gjatë vitit 2016 – 2029.

Për të kuptuar më mirë dhe shpjeguar kontekstin e prezantimit të grave në mediat e shkruara në Kosovë, ky “hulumtim do të marrë parasysh edhe metodën e “multimodalitetit” të zhvilluar nga studiuesit Kress dhe van Leeuëen. Sipas kësaj metode, përveç kategorive bazike të linguistikës si fjalët, fjalitë apo paragrafët, nevojiten terma më të përgjithësuar të cilat lejojnë analizë më të thukët të materialeve të cilat shpesh përmbajnë në vete elemente tjera jashtë këtyre kategorive bazike. Module në këtë rast janë teksti, fotografitë, ilustrimet, ngjyrat, madhësia e shkronjave dhe të gjitha elementet tjera që mund të hasen në artikull, e të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi kontribuojnë në prezantimin e materialit”[43].

Historikisht, mediat janë të njohura për qasjen dhe përdorimin e një gjuhe të caktuar gjatë prezantimit të çështjeve të ndryshme në artikuj. Për këtë qëllim, shpeshherë gjatë shtjellimit të kontekstit me ose pa qëllim përdorin gjuhë e cila shpeshherë merr konotacione negative, steriotipizuese, tituj bombastik ose titulli ndryshe e artikulli ndryshe dhe qasje të ngjashme me qëllim të një artikull të bëhet sensacion, të ketë vëmendje më të madhe shoqërore apo edhe të zhvendoset vëmendja nga problemet ditore në probleme të tjera. Ndaj, për të analizuar më detajisht artikujt e mbledhur,

42 Anitasari, Deti: “*Critical Discourse Analysis: Mass Media*”, Department of English Education, Faculty of Teacher Training and Education, Universitas Lancang Kuning, fq. 5.

43 Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: “*Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2014-2015*”, ABGJ, Prishtinë, fq. 27.

analiza është bazuar në disa pyetje:

1. Nga cili këndvështrim apo qasje shprehen këto emërtime, atribuime dhe argumente?
2. Cilat cilësi, karakteristika dhe tipare u atribuohen atyre?
3. Si emërtohen dhe referohen personat nga ana gjuhësore?
4. Me anë të cilit argumente personat specifik ose grupet shoqërore përpiqen të justifikojnë dhe legjitimojnë diskriminimin dhe shfrytëzimin e të tjerëve?”[44].

Analiza ka pasur për qëllim që të analizon detajet e artikujve, informatat, qasjet, titujt, imazhet e fotografive dhe dimensionet e tyre, hapësirën se ku është vendosur artikulli, si është trajtuar, si është fokusuar dhe çfarë përmbajtje ka pasur. Në këtë kontekst, artikujt janë analizuar në tri pjesë: a) titulli i artikullit, b) pjesa hyrëse, dhe c) trupi (trungulli) i artikujve. Megjithëse, gjatë analizës së artikujve do të merren parasysh edhe elementet tjera gjuhësore, si: struktura tematike e tekstit, fokusi i informacionit, përdorimi i metaforave, foljet, emrat, mbiemrat, cilësia e zërit, leksikalizimi, e të tjera.

Prandaj, hulumtim synon të analizojë mënyrën, formën dhe qasjen se si paraqitën gratë ne mediat e shkruara në Kosovë, bazuar në gazetat e mbledhura, artikujt e monitoruar dhe materialin përfundimtar të dorëzuar nga Agjencia për Barazi Gjinore – ABGJ. Gjatë kësaj faze, janë mbledhur dhe monitoruar artikujt nga 5 gazeta ditore në Kosovë, të cilat janë publikuar në vitin 2016 – 2019”[45].

## 4.2. Mostra e analizës cilësore

Zakonisht gjatë paraqitjes së prezantimit të grave në mediat e shkruara, rol dhe rëndësi të madhe ka analiza sasiore e cila pasohet nga analiza cilësore e artikujve, të cilët më parë janë përzgjedhur dhe janë kodifikuar. Përderisa analiza sasiore ka për qëllim që të pasqyrojë më shumë sasinë (numrin) e artikujve që kanë të bëjnë në këtë rast me gratë, fushat dhe hapësirat në të cilat janë paraqitur ato, analiza cilësore fokus ka më shumë analizën e materialit, mënyrën e përfaqësimit të grave, kontekstin situacional dhe

44 Anitasari, Deti: “*Critical Discourse Analysis: Mass Media*”, Department of English Education, Faculty of Teacher Training and Education, Universitas Lancang Kuning, fq. 4.

45 Gazetat ditore në vitin 2016 – 2019: *Kosova Sot, Koha Ditore, Bota Sot, Zëri dhe Epoka e Re*.

kohor, sfondin e vizuelizimit, trajtën e artikujve nga pikëpamja gjinore, si dhe segmente të cilat në një ose tjetrën mënyrë i japin kuptim cilësor analizës. Prandaj, analiza sasiore fokus ka më shumë qasjen numerike të artikujve, analiza cilësore vë në pah kontekstin dhe përfaqësimin e grave në medie. Në këtë drejtim, me qëllim të nxjerrjes së rezultateve sa më të pasura, artikujt e përzgjedhur dhe të analizuar janë përzgjedhur në bazë të kritereve në vijim:




Vlen të theksohet se analiza e artikujve në vijim është gjithëpërfshirëse, që do të thotë se janë marrë parasysh dhe analizuar të gjitha elementet relevante të cilat e bëjnë një artikull objektiv dhe profesional, apo të njëanshëm dhe tendencioz. Një analizë e tillë është paraqitur edhe gjatë vitit 2014 – 2015 nga Agjencia për Barazi Gjinore. Fokusi i analizës cilësore të artikujve ka qenë jo vetëm forma dhe mënyra e portretizimit të gruas në mediat e shkruara, por gjithsesi edhe aspekti pozitiv, negativ, qasja e autorëve/gazetarëve për artikujt/storiet e trajtuara, profesionalizmi dhe respektimi i kodit etik gazetaresk.

Së këndejmi, duhet thënë se përzgjedhja e artikujve për të qenë pjesë e analizës cilësore është zgjedhur me kujdes, në mënyrë që të përfshihen

fusha të përgjithshme, ku janë paraqitur gratë, përfshirë këtu: gratë në politikë, në sport, gratë në muzikë, kronikat e dhunës në familje, gratë në shëndetësi, barazia gjinore, si dhe fusha të tjera. Artikujt janë zgjedhur sipas fushave (temave), viteve dhe gjithsej janë analizuar 14 artikuj, të cilët i kemi paraqitur, më poshtë, si vijon:

**Artikujt e analizuar**

Në kuadër të analizës së diskursit social kritik dhe analizës të multimodalitetit janë analizuar këto artikuj, si vijon:

- “Falë operacionit të lukthit, tani është bërë tjetër njeri, artikull në Kosova Sot”.
- “Partia e Mimozës & CO, MASHË e Oligarkëve”.
- “Ferizaj prin në zbatimin e barazisë gjinore për pronën e paluajtshme”.
- “17 vjet pas, asnjë i dënuar për dhunimet gjatë luftës”.
- “RrGGK-ja: Gratë të nënpërfaqësuara në MAShT”.
- “E madhja Majlindë!”.
- “20 raste të dhunës ndaj grave për 5 muaj”.
- “Presidente “Zarfi”.
- “Gratë të diskriminuara në buxhetim kundrejt burrave”.
- “The Time’: Dua Lipa e vë Prishtinën në hartën e pop – muzikës”.
- “Më shumë se 80 për qind e grave në Kosovë punojnë pa kontrata pune”.
- “Arta Dobroshi, aktorja më e mirë në festivalin francez”.
- “Pacientet në Klinikën e Gjinekologjisë detyrohen që ta blejnë vetë ampulën Oxytocin”.

# Falë operacionit të lukthit, tani është bërë tjetër njeri

KOSOVA SOT
E hënë, 3 prill 2017 | 13

KISHTE PROBLEM ME MBIPESHË, HEQ 60 KILE



## Falë operacionit të lukthit, tani është bërë tjetër njeri

### I thanë se nuk mund të bëhej nënë, prandaj vendosi të hiqte kilet e tepërta

**Nga 136 kile, sa kishte pasur për një periudhë të gjatë të jetës së saj, pas zvogëlimit të lukthit me operacion, Daniela Beris tani ka vetëm 75 kile dhe ndjehet për mrekulli**

Edhe pse Daniela Beris, nga Melburni i Australisë, e dinte se vuante nga kilet e tepërta, ajo nuk kishte ndërmarrë asgjë në këtë drejtim, derisa ia refuzuan mundësinë e shtatzënësisë me IVF (fekondim artificial), për shkak të mbipeshës. Për ta larguar problemin me mbipeshë, 35 vjeçja vendosi që ta zvogëlonte madhësinë e lukthit me anë të operacionit. Ajo tregon se, sapo mjekët e kishin refuzuar për IVF menjëherë kishte rënë në depresion. Por, ai moment ia kishte ndryshuar jetën. Tani, kur kanë kaluar gati dy vjet, zonja Beris ka rënë nga 136 në vetëm 75 kile, kryesisht falë operacionit të lukthit.

**Tani, derisa pret ta bëjë IVF-në, për t'u bërë nënë, të gjithëve që kanë problem me mbipeshë, ua preferon operacionin e lukthit**

**Ajo ha 6 - 8 shujta të vogla në ditë**

"Dukem tepër e bukur, gjë që kurrë nuk kam mundur ta them deri më tani", deklaron ajo. "Tani mund të shkoj në dyqane dhe të blej rroba për veten time. Të gjitha rrobat që më pëlqejnë, tani më bien tamam".

Daniela ha 6 - 8 shujta të vogla në ditë:

**Kafjalli:** Jogurt me drithë.

Zamra: Djathë, bajame, arra apo perime.

**Dreka:** Sallatë.

Zamra e pasdites: Një copë peme.

Kur të kthehet nga puna në shtëpi: Çipsa, apo të ngjashme.

Darka: Peshk apo çomlek.

**Ajo thotë se peshën prej 75 kilesh e arriti brenda një viti**

Beris thotë se, që nga fëmijëria kishte ngrënë sa herë kishte dashur. Kur kishte qenë e gëzuar, kishte ngrënë, kur kishte qenë e mërzitur, kishte ngrënë. Ajo vazhdimisht kishte ushtruar, por më kot.

Pra, sikur të mos ishte pamundësia që të bëhej nënë, asaj kurrë nuk do t'i kishin penguar kilet e tepërta.

Ajo thotë se peshën prej 75 kilesh e arriti brenda një viti. Tani ajo ha çka t'ia dojë qejfi, por në sasi të kufizuar. Ajo ha edhe çokollata, petulla, çipsa, edhe atë çdo ditë të kohës. Tani, derisa pret ta bëjë IVF-në, për t'u bërë nënë, të gjithëve që kanë problem me mbipeshë, ua preferon operacionin e lukthit.

Artikulli i botuar me datë 03 prill 2017 në gazetën *Kosova Sot* ( artikull i përkthyer ) i paraqitur në kuadër të hapësirë së 'Shëndeti' paraqet një titull joprofesional rreth temës së shëndetit që nuk arrin ta përkthej në terme të mirëqenies shëndetësore ku mbi pesha fillimisht rrezikon shëndetin e individit. Titulli në shikim të parë nuk pasqyron shëndetin e gruas, por ka fokus transformimin njerëzor përmes transformimit fizik, duke e paraqitur pamjen fizike si diçka jo natyrale dhe jo të akceptueshme. Ky artikull po ashtu pasqyron një mesazh jo të mirë, duke treguar se modeli më i mirë është transformimi fizik, pavarësisht efekteve shëndetësore që mund të ketë. Artikulli e rrit dukshëm mendësinë stereotipizuese për dukjen e gruas, që ajo të jetë e pranueshme duhet të plotësoj kriteret vizuele përmes 'dimensioneve' trupore. Fotoja e paraqitur ka dimensionet 9.3cm me 8cm dhe fokus ka dy profile të së njëjtës grua e cila në profilin e parë paraqitet gruaja e cila është mbipeshë dhe nëntitulli tjetër thekson se ajo nuk mund të bëhej nënë sepse ka kile të tepërta dhe profili i dytë pasqyron një ndryshim drastik e cila tashmë ka hequr 61 kg.

Siç shihet artikulli edhe mund të jetë marrë nga ndonjë medie rajonale apo ndërkombëtare dhe është përshtatur kontekstit audiencës, duke tërhequr vëmendjen me një titull goxha bombastik dhe joprofesional, Pra, artikulli nuk pasqyron ndonjë vlerë të caktuar shoqërore, kulturore ose shëndetësore, por më shumë paraqet një përshkrim dhe në mënyrë indirekte nxit transformimin jo natyral të pamjes fizike të gruas. Gjithashtu, kjo ushqen norma stereotipizuese për pamje 'të pranueshme' duke anashkaluar rëndësinë që mund të arrinte duke folur mbi problemet shëndetësore që mund të ketë individi mbi peshë.

**Partia e Mimozës & CO, MASHË e Oligarkëve**



KOSOVA SOT

www.kosova-sot.info

18 VJET

E PREMTE, 22 KORRIK 2016, ÇMIMI 0.40 €, VITI XVII, NR. 6090

THEMELUES: RUZHDI KADRIU

EDITORIALI

Mërgimtarët në Kuvendin e gazit

PARALAJMËRIMET E SUBJEKTIT TË RI POLITIK

Partia e Mimozës&CO, MASHË E OLIGARKËVE

Kryetarja e Gjakovës shfrytëzoi Pacollin, tash në gjuetinë e radhës

"Zonja Kusari është treguar fillimisht e pasuksesshme në ministri, ka bërë edhe skandale antiligjore, jo të pakta, por mjaft të shumta... Përveçse në ministri, është treguar e pasuksesshme edhe në Komunën e Gjakovës, nuk ka treguar asnjë sukses të prekshëm, por i njëjti dështim, që e ka pasur në ministri, e ka përcjellë edhe në drejtimin e Komunës së Gjakovës, kështu që gjasat janë kurrfarë që ajo të mund të bëjë një subjekt të ri politik dhe të ndikojë në ndryshime pozitive", tha prof. Riza Smaka për "Kosova Sot"

Artikulli i botuar me datë 22 korrik 2016 në gazetën *Kosova Sot*, paraqet një titull jo serioz dhe joprofesional ndaj një grua e cila ishte edhe kryetare e komunës së Gjakovës, duke e përshkruar atë si 'vegël e Oligarkëve', duke pasqyruar si bashkëpjesëmarrëse e grupeve klanore. Artikulli po ashtu, ka edhe një nëntitull tejet nënçmues për gruan, duke e paraqitur atë si 'shfrytëzuese' e të tjerëve/grupit, por jo si grua e suksesshme që kontribuon për subjektin që përfaqëson dhe vendimmarrjen në politikë. Më tej, në ballinë, artikulli citon edhe ish profesorin universitar të ndjerë Smaka lidhur me skandalet e ish kryetares së komunës së Gjakovës, duke ia atribuar një sërë shkeljesh ligjore. Në kontekstin më të gjerë juridik dhe social, një verdikt të tillë mund të jep vetëm Gjykata dhe assesi një individ ose medium, kjo lë të kuptohet se shpeshherë mediat përdorin pushtetin e tyre për propagandë pa u mbështetur në fakte konkrete për vepra penale të mundshme.

Artikulli paraqet një grua politikane e cila njëkohësisht është grua e vetmja kryetare e një komune dhe (artikulli) si i tillë i paraqitet lexuesit si imazh negativ, pa sjellë të dhëna faktike nga institucionet e drejtësisë të konfirmuara për fajësinë apo pafajësinë e saj.

Fotoja e pasqyruar në ballinën e gazetës ka dimensionet 9.5cm me 6.5cm dhe shihet se një pjesë goxha të madhe të hapësirë e zotëron titulli i cili

bie më shumë në sy. Prapavija e fotos që reflekton ish pozicionin e saj në Qeveri, e bënë akoma më të fuqishëm kontekstin negativ të pozicionit të saj, duke e lidhur pozitën e saj aktuale me të kaluarën politike. Kjo njashtu jep nuanca negative për gruan, pa e verifikuar vërtetësinë e akuzave, duke e sforcuar stereotipin se gratë '*shfrytëzojnë pushtetet*' për plotësuar apetitet politike të grupeve klanore.

**Ferizaj prin në zbatimin e barazisë gjinore për pronën e paluajtshme**



Ferizaj prin në zbatimin e barazisë gjinore për pronën e paluajtshme

NOTESI telefonik

Artikulli i botuar me datë 05 nëntor 2018 në gazetën *Koha Ditore,* është një nga artikujt që pasqyrojnë një shembull pozitiv në shoqërinë kosovare. Artikulli flet për zbatimin e legjislacionit për barazi gjinore, me theks të veçantë regjistrimin e pronës së paluajtshme për të dy gjinitë si segment i rëndësishëm shoqëror. Gjithashtu, kjo pasqyron ndërmarrjen e masës afirmative për regjistrimin e pronave në emër të dy bashkëshortëve. Edhe pse artikulli ka kryesisht një përmbajtje pozitive dhe jep një mesazh dhe inkurajon të dy gjinitë për një veprim të tillë, në kontekstin analitik nuk e përmbush në tërësi modelin afirmativ, meqenëse në artikull nuk pasqyrohet asnjë opinion i gruas brenda institucionit të pushtetit lokal apo nga opinioni i qytetarëve, gjë që të ndikonte që artikulli të paraqitet më cilësor, më profesional dhe jo vetëm si e dhënë statistikore. Fotoja e paraqitur është foto me dimensione të vogla, me një kualitet të dobët. Kjo

foto ka dimensione 10.5 cm me 6cm dhe hapësira e këtij artikulli i cili është dashur që të jetë në ballinë, ndodhet diku kah mesi i gazetës.

Nëse analizojmë me kujdes artikullin, mund të konsiderohet si shembull pozitiv i prezantimit të barazisë gjinore dhe njëkohësisht shërben si model për komunat dhe qytetarët që të ndjekin shembullin e mirë të prezantuar në këtë artikull për të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve si e drejtë njerëzore. Gazetari i artikullit është objektiv, i paanshëm Megjithatë, artikulli nuk përmban të dhëna të tjera statistikore krahasuar me komunat tjera, të cilat lexuesit do t'ju ofrohej një e dhënë e saktë lidhur me regjistrimin e pronës së paluajtshme e cila do të pasqyronte saktësisht modelin që është krijuar. Model ky i cili do të reflektonte si mesazh i inkurajimi për të ndërmarr hapa afirmativ për këtë qëllim.

**17 vjet pas, asnjë i dënuar për dhunimet gjatë luftës**


17 vjet pas, asnjë i dënuar për dhunimet gjatë luftës

Presidentja Jahjaga ka thënë se krimi i dhunës seksuale i kishte mbajtur viktimat të burgosura brenda tmerreve të cilat i kishin përjetuar, të heshtura, të stigmatizuara dhe të turpëruara nga mbarë shoqëria. "Ndërsa ne zgjodhëm heshtjen, ne si individë, si shoqëri dhe si institucione u bëmë pjesë e padrejtësisë së kryer mbi viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës", ka shtuar ajo

Ky artikull është  botuar me datë 31 mars 2016 në gazetën *Koha Ditore,* i cili pasqyron një nder plagët më të rëndë të luftës. Artikulli elaboron mungesën e ndëshkimeve për dhunimet gjatë luftës dhe kujtesën për trajtimin çnjerëzor të grave të dhunuara gjatë luftës. Autorja e artikullit, citon ish presidenten Jahjaga duke thënë se '*Kosova në dy vitet e fundit ka treguar përkushtim për luftimin e stigmatizimit të këtyre viktimave, duke u bërë*

*thirrje të mbijetuarve të dhunës seksuale që të mos e ndjejnë vetën të turpëruar'*.

Gjithashtu, artikulli bënë thirrje sensibilizimin e institucioneve të vendit dhe mekanizmave ndërkombëtar për ndjekjen dhe vënien para drejtësisë të gjithë akterët të cilët kanë qenë pjesë e këtyre krimeve. Artikulli adreson rolin e Këshillit Kombëtar për Mbijetuarat e Dhunës Seksuale gjatë luftës në Kosovë, kur për herë të parë institucionet e vendit dhe shoqëria kosovare me një zë shprehin vendosmërinë për të thyer tabunë e cila e kishte preokupuar shoqërinë kosovare që nga lufta. Titulli tregon një brengë të madhe të institucioneve dhe shoqërisë kosovare se 17 vjet pas luftës ende nuk ka asnjë person të dënuar për dhunimet gjatë luftës. Artikulli fokusin vë tek Presidentja Jahjaga dhe përkushtimin e saj per përkujdesje ndaj të mbijetuarve. Më tej, në këtë artikull përshkruhet edhe kontributi i njerëzve të artit, muzikës dhe kulturës për sensibilizimin e opinionit të gjerë për mbrojtjen sociale dhe institucionale të viktimave seksuale të luftës, si dhe mos stigmatizimin e tyre në shoqëri.

**RrGGK-ja: Gratë të nënpërfaqësuara në MAShT**


Publikohet raporti "Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë"

RrGGK-ja: Gratë, të nënpërfaqësuara në MAShT

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), sipas raportit të publikuar "Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë", ka vlerësuar se gratë janë të nënpërfaqësuara në radhët e punonjësve në Ministrinë e Arsimit. Drejtoresha ekzekutive e RRGGK-së, Igballe Rogova, ka thënë se barazia gjinore nënkupton të drejtat e barabarta në mes të burrave dhe grave

Eldona KUQI

Artikulli i botuar me 03 qershor 2016 në gazetën *Epoka e Re*, përshkruan publikimin e raportit *'Buxhetimi drejt një arsimimi më të mirë'*, artikull ky i cili vlerëson se përfshirja e grave në Ministrinë e Arsimit është e

nënpërfaqësuara. Gazetarja paraqet në këtë artikull ngjarjen e zhvilluar në këtë rast dhe diskutimin me pjesëmarrësit lidhur të gjeturat e RrGGK-ja lidhur me pjesëmarrjen e grave përfaqësim në institucioneve akademike dhe MAShT.

Sipas përshkrimit të artikullit, raporti ka pasur dy qëllime kryesore: a) qëllimi i parë i këtij hulumtimi ka qenë që të arrihet analiza e parë e thellë gjinore të MAShT dhe Universiteteve Publike dhe b) përmes këtij hulumtimi synohet të mbështetet MAShT-i në zvogëlimin e pabarazive gjinore.

Artikulli portretizon foton e akterëve pjesëmarrës me rastin e paraqitjes së këtij raporti edhe pse fotoja është e vendosur në mes të artikullit. Fotoja po ashtu është e mbuluar me tekst rreth e përqark dhe e cila përmban logon e RrGGK-së, por që dukshmëria e fotos është pa ngjyra dhe jo shumë e qartë dhe se dimensionet e saj janë 10cm me 6cm. Megjithatë, ajo pasqyron temën e diskutimit dhe akterët, ku lexuesi mund të vëren elemente të një diskutimi në këtë ngjarje. Artikulli mund të cilësohet si prezantim pozitiv, për arsye se paraqet një ngjarje me karakter mobilizues për institucionet dhe shoqërinë e gjerë, duke u bazuar në të dhënat faktike të dala nga gjetjet e hulumtimit të shoqërisë civile. Artikulli është një thirrje e shoqërisë civile ndaj institucioneve të vendit për adresuar problemet e përfaqësimit gjinor dhe për të bërë më shumë në përfshirjen e grave në institucionet vendimmarrëse në vend.

# E madhja Majlindë!



Medalja e vetme olimpike e Kosovës

# E madhja Majlindë!

## Driton Kuka, trajneri i cili ka hyrë në histori të sportit shqiptar

Majlinda Kelmendi u prit si heroinë e vërtetë pas rikthimit nga Rio, ku fitoi medaljen e artë. Ajo i solli Kosovës medaljen e parë olimpike, por më herët kishte edhe të tjerë shqiptarë që kanë fituar medalje olimpike, por duke përfaqësuar ish-Jugosllavinë apo Gjermaninë. Majlinda do të mbetet në histori të sportit kosovar dhe shqiptar

Majlinda Kelmendi do të mbahet mend si sportistja e parë që i solli Kosovës medalje olimpike. Kjo ishte pjesëmarrja e parë e Kosovës në Lojërat Olimpike dhe Majlinda arriti të stoliset me medalje të artë. Ajo shkroi historinë e sportit kosovar dhe shqiptar në përgjithësi, pasi as Shqipëria nuk ka medalje në Olimpiada. Me suksesin e saj u krenuan të gjithë shqiptarët. Kelmendi katër vite më parë kishte përfaqësuar Shqipërinë, por ishte eliminuar në xhiron e dytë. Ajo deklaroi se medalja është e të shqiptarëve dhe është e lumtur që ka sjell gëzim te populli i saj. Por, më herët edhe tjerë sportistë shqiptarë kanë fituar medalje olimpike, por duke përfaqësuar shtete të tjera.

**Medalja e të gjithë shqiptarëve**

Majlinda nuk bën dallime në mes Kosovës dhe Shqipërisë. "Jam krenare që kam arritur të tregoj që të rinjtë kosovarë mund të arrijnë sukses të mëdha në sport. Faleminderit krejt shqiptarëve për përkrahjen. Katër vjet më parë kam përfaqësuar Shqipërinë, derisa tani Kosovën. Unë gjithmonë kam përfaqësuar popullin tim. Ne jemi një popull", ishte shprehur Majlinda. Edhe trajneri i saj, Driton Kuka, i cili ka merita të mëdha në suksesin e saj ka thënë se kjo medalje është e

Ky artikull është i botuar në 16 gusht të vitit 2016 në *Kosova Sot*, me rastin e fitores së Majlinda Kelmendit të medaljes së artë olimpike në Rio të Brazilit. Titulli i artikullit vë në theks madhështinë e figurës së Majlinda Kelmendit si e arta e parë olimpike e Kosovës së pavarur, e cila arrin në majën më të lartë të sportit olimpik, përkundër vështirësive të mëdha të sportit në përfaqësim ndërkombëtar.

Artikulli pasqyron foton e protagonistes kryesore – Majlindës me dimensionet 16cm me 13cm në krye të faqes së gazetës me medaljen e artë në duar me një buzëqeshje që shpreh gëzimin pas triumfit në lojërat olimpike.

Po ashtu, artikulli pasqyron edhe pritjen si 'heroinë e vërtetë' pas kthimit nga Rio, organizimin në Kosovë dhe mburrjen e komunitetit sportiv dhe shoqërisë kosovare me këtë arritje. Majlinda Kelmendi do të mbahet në mend si sportistja e parë e cila i solli Kosovës medalje olimpike pas pavarësisë.

Ajo që vërehet në këtë artikull është rëndësia dhe imazhi që ka Majlinda Kelmendi në përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke pas parasysh vështirësitë e Kosovës në integrimet në organizatat ndërkombëtare dhe barrierat që ka shteti në përfaqësimin në organizatat ndërkombëtare të sportit. Artikulli është më shumë përshkrues i ngjarjes sportive dhe nuk pasqyron ndonjë analizë më të thellë me përfshirjen e akterëve të ndryshëm dhe njohësve të fushës, të cilët do ta pasuronin artikullin më shumë.

Në shikim të parë, megjithëse potencohet fakti i fitores së medaljes së artë nga Majlinda Kelmendi, artikulli ka edhe pjesën përshkruese për trajnerin e saj Driton Kuka, duke e balancuar fitoren e saj me meritat e trajnerit. Artikulli do të ishte më cilësor sikur të merrej me përshkrimin dhe analizën e fitores së medaljes së artë nga Majlinda Kelmendi dhe me theks të veçantë me punën ekipore të ekipit kombëtar të xhudos.

Artikulli do të kishte mundur që t'i trajtojë më shumë elementet e fitores së Majlindës në vetën e parë dhe më pas me një artikull tjetër ose një paragraf krejt të veçantë të trajtojë historinë dhe sfidat në arritjen e medaljes olimpike nga përfaqësuesja dhe trajneri i saj.

# 20 raste të dhunës ndaj grave për 5 muaj



DUKURI QË KURRSESI TË ÇRRËNJOSET!

"Të gjitha femrave që kanë qenë viktima të dhunës në familje, e që na janë drejtuar për ndihmë juridike, ne ua kemi ofruar atë dhe mund të them se më së shumti ka pasur femra të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, por duke mos anashkaluar edhe femrat e komuniteteve të tjera", është shprehur Valbona Doli-Rizvanolli

# 20 raste të dhunës ndaj grave për 5 muaj

**Kristë Gjokaj: Është rritur dukshëm numri i raportimit të këtij lloji të dhunës**

**Ka nevojë për ndërgjegjësimin personal të femrës**

**Dhuna raportohet me shumë vështirësi**

**"Në 5 muajt e parë të këtij viti, në institucionin tonë kemi të raportuara 40 raste të dhunës në familje që kanë ndodhur në tri komunat që ne i mbulojmë, në Gjakovë, në Rahovec dhe në Malishevë. Vetëm në komunën e Gjakovës kanë qenë 20 raste të dhunës në familje, ku, më së shpeshti viktima kanë qenë femrat", shprehet Doli-Dobruna**

Ky artikull është botuar me datë 15 qershor, 2016 në gazetën *Kosova Sot* dhe flet për një dukuri e cila sa vjen e rritet në shoqërinë kosovare. Artikulli pasqyron numrin e rasteve të dhunës ndaj grave për 5 mujorin e parë të vitit 2016, duke potencuar se vetëm brenda kësaj periudhe janë 20 raste të dhunës. Autori i artikullit vë në pah mungesën e ndërgjegjësimit në shoqëri lidhur me dukurinë e dhunës dhe për sfidat dhe vështirësitë e raportimit të kësaj dukurie.

Artikulli po ashtu analizon këtë fenomen, duke e pasqyruar përmes intervistave nga akterët institucional përgjegjës siç është policia e Kosovës në të cilin potencohet se numri rasteve të dhunës më shumë ka të bëjë me rritjen e ndërgjegjësimit të gruas për raportim se sa që është rritur numri i rasteve. Në këtë artikull po ashtu gazetari ka marr mendimet/opinionet e akterëve të tjerë institucional dhe të organizatave të shoqërisë civile, duke potencuar edhe anën tjetër të këtij fenomeni, përkatësisht rritjen e numrit të rasteve.

Artikulli po ashtu shoqërohet me një citat nga përfaqësuesja e Ministrisë së Punës – Qendra për Punë Sociale në Gjakovë e cila flet për ndihmën e ofruar dhe rastet më të shpeshta të këtij fenomeni të cilat janë nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Artikulli ka një qasje përshkruese dhe profesionale në trajtimin e temës, është i balancuar dhe sjellë informacion të mjaftueshme, sepse përveç përshkrimit të këtij fenomeni, gazetari ka marrë këndvështrime të ndryshme lidhur me temën që ka trajtuar, duke ballafaquar argumentet e ndryshme nga akterët e ndryshëm. Mund të ofroheshin edhe opinionet e viktimave, por gjithsesi se qasja është profesionale.

# Presidente 'Zarfi'



KOHA Ditore — arbëri

PROFILI I ISH-PRESIDENTES, ATIFETE JAHJAGA

## Presidente "zarfi"

**Presidentja Jahjaga e çoi në fund një mandat që e kishte marrë për ta ushtruar vetëm për pak më shumë se një vit. Rrugëtimin, duke qenë në krye të shtetit, e bëri me autoritet të lënduar brenda Kosovës. Nuk ia lënduan vetëm gafat, por edhe mungesa e fuqisë politike. Jashtë ka pasur tjetër respekt. Është pritur nga personalitetet më të larta vendimmarrëse politike, dhe ka qenë pjesë e shumë forumeve ndërkombëtare. Jahjaga do të mbahet në mend më së shumti për avokimin rreth të drejtave të grave**

Artikulli është botuar me datë më 07 prill 2016 në gazetën *Koha Ditore*, paraqet një profil të ish presidentes së Kosovës Jahjaga. Titulli i artikullit qysh në pamjen e parë jep konotacionin pezhorativ të ushtrimit të funksionit të një gruaje në krye të shtetit, si grua e cila ka ardhur përmes kompromisit politik. Por, media dhe shoqëria në përgjithësi e ka atakuar në mënyrë të vazhdueshme, duke e lënduar edhe fuqinë politike të pozicionit që e ka ushtruar me shprehje të cilat nuk janë etike.

Vetë titulli 'Presidente 'zarfi' dhe përshkrimi në hyrje të tekstit jep një mesazh negativ për lexuesin, titull i cili është vështirë që të gjendet për një burrë në medie, duke potencuar se ky 'zarf' është një kompromis për një periudhë të shkurtër disa mujore, duke paragjykuar se ky mandat do të jetë jo i plotë, përkundër faktit që Kushtetuta rregullon çështjen e mandatit të peridentitit. Artikulli potencon polarizimin e dy anëve të së njëjtës medalje, duke e paraqitur ish presidenten Jahjaga si reprezentative në arenën ndërkombëtare, në veçanti tek avokimi për të drejtat e grave, por duke mos atribuuar këto vlera në raport me çështjet e brendshme.

Ky artikull vërehet se është shumë përshkrues dhe në aspektin cilësor është shumë kontradiktorë, për arsye se vënë që në fillim mënyrën dhe formën e zgjedhjes së saj si presidente, pastaj artikulli fokusohet në fillimin e ushtrimit të detyrës, takimet ndërkombëtare, duke potencuar faktin se është gruaja e parë presidente e një vendi në rajon. Ky fakt, nënvizohet në artikull se ka qenë jo me pak peshë në imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtar në avancimin e rolit të grave në vendimmarrje. Artikulli është i pa balancuar dhe vet autori bie ne kundërshtim me vetveten duke ofruar opinione personale, te cilat serish i mohon me fakte dhe te arritura te presidentes ne nivel vendore dhe ndërkombëtarë, duke ja njohur kontributin se megjithatë Presidentja dëshmoi një agjende dhe vizion ne fushën e barazisë gjinore, dhe ndërkombëtarizimit te Kosovës.

Si duket autori i artikullit është munduar që të krijoj një baraspeshë në mes qasjes përshkruese dhe imazhit të ish presidentes në shoqërinë kosovare. Por, artikulli që në fillim vërehet se është më shumë stigmatizues, i mbushur me tekst përshkrues dhe me cilësime jo profesionale dhe etike.

Profili i pasqyruar përmes fotos me dimensionet 11cm me 5cm është sinjal i qartë se autori mundohet që të ndërlidhë titullin me fotografinë e cila

reflekton se del 'nga zarfi', ku profili i saj është i pasqyruar në mënyrën jo të drejtë, pasi që presidenti duhet të reflektoj edhe përmes fotove autoritetin më të lartë shtetëror të një vendi. Fotografia e pasqyruar ka një asimetri me hapësirën e tekstit, e cila jep një mesazh jo të mirë. Artikulli është më shumë përshkrues dhe nuk paraqet ndonjë vlerë të shtuar të trajtimit të kësaj çështjeje, për shkak se është stigmatizues, jo i balancuar, i pa mbështetur në argumente apo fakte meritokracie apo të kundërta. Gjithashtu, artikulli bartë mesazh personal të individit të pa argumentuar me fakte dhe ta dhëna të besueshme për performancë individuale të Presidentes dhe si i tillë konsiderohet paragjykues dhe jo etik.

# Gratë të diskriminuara në buxhetim kundrejt burrave

DREJTORIA E BUXHETIT E FERIZAJT NXJERR DRAFT DOKUMENTIN E BUXHETIT NË BAZA GJINORE

## Gratë të diskriminuara në buxhetim kundrejt burrave

**Një raport i publikuar tregon se 72 për qind e buxhetit është harxhuar për punëtorët meshkuj e vetëm 27 për qind për femra pa u përfshirë punonjësit e sektorit Shëndetësisë dhe atij të Arsimit**

Agim Ademi

FERIZAJ, 26, KORRIK – Një draft-dokument i përgatitur nga Drejtoria komunale e Buxhetit dhe Financave për harxhimin e buxhetit në baza gjinore për femra i quajtur si buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, ka treguar se gjatë vitit 2016 në Komunën e Ferizajt është harxhuar buxheti në masë më të madhe për pagat e meshkujve në raport me pagat e grave.

Ky raport tregon se 72 për qind e buxhetit është harxhuar për punëtorët meshkuj e vetëm 27 për qind për femra pa u përfshirë punëtorët e sektorit Shëndetësisë dhe të Arsimit.

Ndërsa me përfshirjen e tyre vërehen hapa pozitive dhe përqindja rritet në favor të kënaqshëm për gratë dhe raporti qëndron 47. 34 buxhet i harruar për pagat e burrave dhe 52. 66 buxhet i harxhuar për gratë.

Në takimin e organizuar nga organizata e OSBE-se për këtë temë është lavdëruar puna e bërë për një analizë të tillë nga punonjësit e Komunës së Ferizajt, por shfaqet nevoja që gratë të avancohen edhe më tej, veçanërisht nëpër pozitat udhëheqëse për të pasur qasje më të barabartë edhe në buxhet.

Kryetari i Komunës së Ferizajt e ka çmuar lart këtë iniciativë për të parë pozitën e gruas dhe nevojat për ndryshime në këtë aspekt, ndërsa është zotuar se përkrahja për gratë do të jetë edhe më e madhe dhe se do të shtojë kujdesin që ato të marrin sa më shumë pozita udhëheqëse.

"Dokumenti në fjalë na tregon qartë se ne nuk jemi në nivelin që do të dëshironim sa i përket buxhetimit gjinor, prandaj do të rritim vëmendjen që gratë të kenë sa më shumë hapësirë dhe kompetenca për vendimmarrje.

Përvoja në këtë qeverisje ka treguar se gratë janë treguar shumë të mira në punët dhe përgjegjësitë që kanë pasur posaçërisht në menaxhimin e mirë të parasë publike dhe kjo dëshmon se kuotat numerike nuk do të na duhen më.

Analiza e që është bërë nëpër disa drejtori të Komunës tregon se ka mjaft femra të angazhuara, por që nuk kanë pasur shumë pozita udhëheqëse dhe si pasojë paga e tyre mund të jetë më e ulët. Ndërkaq, për të ardhmen do të bëjmë një luftë me të madhe për vënie të sa më shumë grave në pozita udhëheqëse për të ecur drejt standardeve moderne ku nuk diskutohet gjinia në buxhetim apo punësim, por vetëm aftësitë dhe shkathtësise për t'i kryer detyrat e kërkuara", ka thënë kryetari i Komunës së Ferizajt, Muharrem Svarqa gjatë takimit të sotëm.

Të dhënat e prezantuara sot kanë treguar se Komuna e Ferizajt ka bërë hapa mjaft pozitive viteve të fundit edhe në dhënien e subvencioneve të ndryshme për gratë dhe kjo u konsiderua si një arritje dhe shtytje e mirë për këtë kategori.

Të pranishmit në diskutimin për ndarje të buxhetit në baza gjinore shfaqën nevojën që gratë të jenë sa më aktive në kërkim të të drejtave të barabarta për punë, udhëheqje biznesi dhe nevoja të tjera që mund të kenë.

Ndërsa u shfaq mendimi se barrierat e dikurshme po tejkalohen gradualisht me shkollimin e sa më shumë grave dhe përkrahjen institucionale të treguar së fundi.

© KOHA Ditore



**Në një takim, organizuar nga organizata OSBE për këtë temë është lavdëruar puna e bërë për një analizë të tillë nga punonjësit e Komunës së Ferizajt, por shfaqet nevoja që gratë të avancohen edhe më tej, veçanërisht nëpër pozitat udhëheqëse për të pasur barazi edhe në buxhet. E kryetari i Ferizajt e ka çmuar lart këtë iniciativë për të parë pozitën e gruas dhe nevojat për ndryshime në këtë aspekt**

Artikulli është botuar me datë 26 korrik 2017 në gazetën *Koha Ditore*, paraqet raportin e publikuar nga drejtoria komunale e buxhetit dhe financave e komunës së Ferizajt për shpenzimet buxhetore. Me fokus të veçantë shpenzimet e buxhetit në masë të madhe për pagat e burrave kundrejt grave, në raport specifikohet se 72% e buxhetit është shpenzuar për punëtorët burra në raport me 27% për gratë.

Titulli i artikullit është pasqyrë e realitetit në shoqërinë kosovare dhe fotoja e vendosur me dimensionet 8cm me 10cm të ngjarjes pasqyron ngjarjen e cila kryesisht dominohet nga burrat se sa gratë dhe e cila reflekton me përqindjen e dominimit të burrave në raportin e pasqyruar. Artikulli ka më shumë qasje përshkruese të ngjarjes e cila është mbështetur nga organizatat ndërkombëtare në Kosovë, të cilat kanë fokus këto tema, por mungon shtjellimi dhe analiza detaje e artikullit. Në artikull nuk është marrë ndonjë intervistë qoftë me akterët të cilët e kanë publikuar këtë raport, me organizatën mbështetëse apo edhe me akterët e pushtetit lokal të komunës së Ferizajt, përkatësisht kryetarin e komunës.

Artikulli do të ishte më cilësor, sikur fillimisht pamja të reflektonte më shumë një balancë gjinore,  foto më profesionale dhe te ofronte opinionet e akterëve pjesëmarrës dhe shoqërisë civile që monitorojnë këtë komunë. Gazetari, si duket është fokusuar më shumë në aspektin përshkrues se sa hulumtues të artikullit. Ajo që i mungon këtij teksti, është ngritja e çështjes në nivel të diskutimit me lexuesin për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të grave në buxhetimet gjinore dhe në pozita vendimmarrëse. Artikulli nuk përmban analizë adekuate nuk janë trajtuar obligimet ligjore për përfaqësim adekuat gjinorë dhe situata në teren, respektivisht pjesëmarrja e grave në vendimmarrje dhe përfaqësimin sipas obligimeve të Ligjit për Barazi Gjinore.

## ‘The Time’: Dua Lipa e vë Prishtinën në hartën e pop - muzikës



"The Times": Dua Lipa e vë Prishtinën në hartën e pop-muzikës

"Duke ndjekur hapat e Rita Orës, këngëtarja me zë të thellë, Dua Lipa, po e vë Prishtinën në hartën e muzikës pop", shkruan "The Times". Dua Lipa thotë për Orën se është inspirim për të, e para nga Kosova, "e cila arriti të bëjë gjëra të mëdha". "A mundet Lipa të arrijë sukses më të madh?", pyet gazetari Ed Potton

Artikulli i botuar me datë 02 shkurt 2017 në gazetën *Koha Ditore*, flet për admirimin që iu është bërë këngëtares kosovare me famë botërore Dua Lipa nga gazeta e njohur ‘The Times’. Artikulli është përmbledhje e intervistës së këngëtares Dua Lipa për gazetën e njohur ‘The Times’ Ky artikull përshkruan historinë e rrugëtimit të këngëtares drejt majave botërore, duke e portretizuar si ‘model’ për gratë dhe vajzat tjera nga një vend i vogël siç është Kosova. Krahas Dua Lipës, potencohen edhe artist të tjerë shqiptarë si Rita Ora e cila ka arritur po ashtu në majat e muzikës botërore.

Artikulli përshkruan vlerën e këngëtarëve, duke e lartësuar prejardhjen e

tyre dhe mburrjen e tyre. Madje, citojnë Dua Lipën *'Ne jemi shumë krenarë prej nga vijmë; gjithmonë ju tregojmë të tjerëve se jemi nga Kosova'*.

Edhe pse artikulli është marrë nga gazeta e njohur dhe është përkthyer, ai në vete pasqyron një dimension pozitiv dhe është një artikull me përshkrim për sukseset e artistes kosovare.

Pasqyrimi i fotos së Dua Lipës me dimensionet 12cm me 21cm në ballinën e shtojcës së kulturës me një pamje të ndritshme reflekton fuqinë, prestigjin dhe pozitivitetin e figurës së këngëtares Dua Lipa. Po ashtu, si imazh paraqitet lulja e cila simbolizon 'paqen' dhe prapavija reflekton imazhin që jep vendit dhe prejardhjes së saj.

Titulli i artikullit reflekton me një imazh të mirë për vendin, sepse përveç tjerash paraqet kryeqytetin e Kosovës – Prishtinës në hartën botërore. Kjo tregon më shumë për fuqinë e prezantimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare nga një grua, duke sfiduar politikën dhe stereotipat karshi kosovarëve

**Më shumë se 80 për qind e grave në Kosovë punojnë pa kontrata pune**



Më shumë se 80 për qind e grave në Kosovë punojnë pa kontrata pune



Artikulli është botuar me datë 24 prill 2017 në gazetën *Zëri*, flet për mungesën e kontratave të punës të një numri të madh të grave të cilat

punojnë. Marrë parasysh që ligji i punës nuk zbatohet plotësisht, sidomos në raport me sektorin privat ku paga minimale është shumë e ulët. Ndërkohë, artikulli është i pozicionuar në të njëjtën faqe të gazetës, ku është paraqitur një reklamë e një kompanie udhëtimesh e cila flet për çmimet e biletave, ku çmimi minimal nuk reflekton pagën minimale të një punonjësi i cili punon pa 'kontratë pune'. Për më shumë balancimi i artikullit me reklamën është në përqindje përafërsisht të njëjtë, duke e minuar rëndësinë e trajtimit të temës në artikull. Pasqyrimi  i kësaj teme është komercializuar me reklamë një faqe e cila bie në sy dhe artikulli do të ishte më cilësor sikur të vendosej në pjesën e sipërme në tërësi dhe në pjesën e poshtme të vendosej një paragraf shtesë i krahasimit të të dhënave me vendet e rajonit.

Artikulli ka një foto me dimensione 8cm me 15cm në ballinë të gazetës, ku fokus ka një grua e cila paraqitet me imazhin e kryerjes së një pune. Ky artikull gjithashtu merr për bazë hulumtimet relevante, duke cituar raportet e ndryshme ku flitet për përqindjen e madhe të grave që punojnë në sektorin privat pa kontrata pune dhe me orare të zgjatura.

Struktura e tekstit është përshkruese me disa intervista të realizuara me akterë relevant, por që mungojnë intervistat me menaxherët ose udhëheqësit e kompanive të sektorit privat. Megjithëse, artikulli përfshinë citimet e grave të cilat punojnë në këtë sektorë dhe argumentojnë faktin e mos zbatimit të ligjit të punës.

## Arta Dobroshi, aktorja më e mirë në festivalin francez


e martë • 16 tetor 2018 — kulturë — KOHA Ditore • 23

AKTORJA KOSOVARE ME NAM BOTËROR VLERËSOHET PËR ROLIN NË FILMIN "STRAY"

# Arta Dobroshi, aktorja më e mirë në festivalin francez

Arta Dobroshi në rolin e Grace, në filmin "Stray", ... "Festival des Antipodes" në St. Tropez të Francës

Artikulli është botuar me datë 16 tetor 2018 në gazetën *Koha Ditore*, paraqet rolin e aktores kosovare Arta Dobroshi në filmin 'Stray' e cila ishte shpallur si aktorja më e mirë në festivalin '*Festival des Antipodes*' në Francë. Titulli i pasqyruar në shtojcën e kulturës është i pozicionuar në pjesën e sipërme të gazetës, duke e paraqitur fuqinë dhe mesazhin e artikullit, në pjesën e sipërme të shtojcës së kulturës, me çka i ofrohet lexuesit në tërësi reflektimin për këtë artikull. Fotoja e paraqitur me dimensionet 10cm me 15cm është ekuivalente me hapësirën e artikullit dhe pasqyron imazhin e aktores nga sekuencat e filmit.

Artikulli po ashtu pasqyron edhe përvojën e mëparshme të aktores, duke potencuar rolet dhe çmimet ndërkombëtare të fituara në kuadër të karrierës së saj filmike. Teksti i paraqitur jep një dimension të vlerës së shtuar artistike dhe model për aktorët e tjerë kosovar për të ndjekur rrugën e cila nuk është e lehtë, por që me përkushtim tregon arritjen deri në këtë stad.

Artikulli pasqyron edhe opinionet e aktorëve të tjerë të përfshirë në rolet e ndryshme në këtë film për aktoren kosovare Arta Dobroshi. Imazhi i paraqitur i aktores kosovare, përveç vlerave artistike, paraqet edhe shtetin e Kosovës si vend ku ka potencial njerëzor në fushën e kulturës, artit, filmit dhe muzikës.

### Pacientet në Klinikën e Gjinekologjisë detyrohen që ta blejnë vetë ampulën Oxytocin



e mërkurë, 4 shtator 2019 — KOHA Ditore — 5

PROCEDURA E LIFERIMIT NË SHOKK, I LË PACIENTËT PA BARNA

# Pacientët në Klinikën e Gjinekologjisë detyrohen që ta blejnë vetë ampulën Oxytocin

**Në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK gratë shtatzëna para se t'i nënshtrohen operacionit janë të detyruara të blejnë ampulën Oxyton. Me këtë problem ato përballen për disa muaj. Zyra për informim e QKUK-së ka bërë të ditur se është lidhur kontrata e re për furnizim për këtë produkt, porse, sipas saj, operatori ekonomik nuk e ka liferuar ende me arsyetimin e mungesës në stok**

© KOHA Ditore

Artikulli është botuar me datë 04 shtator të vitit 2019 në gazetën *Koha Ditore*, i cili trajton një temë shëndetësore me fokus mungesën e barnave esenciale për trajtimin e pacientëve. Artikulli flet për problemet dhe sfidat me të cilat përballen gratë në këtë klinikë, përveç tjerash edhe me mungesën e barnave esenciale. Bazuar në këtë artikull, shihet se shëndeti riprodhues i grave, si përgjegjësi nuk është adresuar në nivelin e duhur, por artikulli fokusohet në relativizimin e problemeve brenda QKUK-së, duke mos adresuar këtë problem si çështje nacionale. Problemi në radhë të parë duhet të trajtohet si mirëqenie e gruas dhe më pas aftësia riprodhuese e saj, gjë në artikull mungon.

Gazetarja në strukturën e këtij teksti, fokusohet për përshkrimin e mungesës së barnave esenciale dhe problemeve me të cilat ballafaqohen pacientët që trajtohen në këtë klinikë, duke vënë theksin më shumë në rolin fiziologjik se sa në shëndetin dhe mirëqenien e gruas. Dimensionet e fotografisë

10cm me 16cm të paraqitur në mes të artikullit, janë të harmonizuara me shkrimin e tekstit, megjithëse fotoja ka një sfond të varfër të ngjyrave të cilat do të reflektonin tek lexuesi një interesim më të madh për lexim.

Artikulli mund të vlerësohet si i mangët, për shkak se përveç trajtimit të problemit, përfshinë disa intervista me akterë të ndryshëm relevant dhe pacientë, por jo edhe me instancat më të larta siç është Ministria e Shëndetësisë. Mënyra se si vlerat e këtij teksti reflektojnë në përshkrimin e gjendjes së përgjithshme në shëndetësi, pasqyrojnë më së miri mungesat dhe problemet që ka ky sektor.

Teksti edhe pse fokusohet në trajtimin e një çështjeje specifike, ka shumëkuptimësi në trajtimin e fenomenit të mungesës së barnave esenciale, duke e prekur emocionin e lexuesit në relacionin me besimin dhe humanitetin që duhet ta kenë mantilbardhët. Artikulli ngrite gradualisht dhe në mënyrë indirekte analogjinë e nevojës së reflektimit dhe ndërhyrjes së shtetit në këtë sektor, me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe kthimit të imazhit dhe besimit.

# 5. Intervistat e thella gjysmë të strukturuara me kryeredaktor dhe redaktor

## 5.1. Metodologjia e punës hulumtuese

Hulumtimet duhet të përfshijnë një qasje të qartë, të disiplinuar dhe sistematike, në mënyrë që të arrijnë rezultatet e dëshirueshme. Në këtë drejtim, hulumtimi cilësor (kualitativ) është i natyrës induktive, sepse eksploron kuptimet, qëndrimet apo njohuritë e situatave, përkatësisht problemeve të caktuara. Hulumtimet cilësore, sikurse ato sasiore ngërthejnë në vete një gamë të gjerë të metodave, instrumenteve dhe teknikave, të cilat janë të nevojshme për arritjen e synimeve. Në kuadër të analizës është përdorur edhe hulumtimi me intervista të thella gjysmë të strukturuara me kryeredaktor dhe redaktor të mediave të shkruara. Si kriter kryesor për përzgjedhjen e pjesëmarrësve për intervistë, ka qenë përvoja në mediat e shkruara, përkatësisht pozita kryeredaktoriale dhe redaktoriale.

Në kuadër të intervistave, pjesëmarrës kanë qenë: 2 kryeredaktor dhe 1 redaktor nga gjithsej 5 intervista të planifikuar për intervistim[46]. Pjesëmarrësit në intervistë kanë qenë gazetarë të cilët pas një përvoje të gjatë në fushën e gazetarisë kanë ushtruar pozitën e kryeredaktorit, përkatësisht redaktorit në gazetën përkatëse.

## 5.2. Gjetjet kryesore nga hulumtimi

Pjesëmarrësit gjatë hulumtimit të zhvilluar, lidhur me rolin e gazetarëve në imazhin e medias në Kosovë dhe ekspertizën për fushën që e mbulojnë, kanë potencuar se në ushtrimin e detyrës së përditshme nuk vërehet ndonjë dallim sa i përket gjinisë me rastin e trajtimit të temave të ndryshme. Redaksitë e mediave të shkruara, kanë kapacitete të mjaftueshme për mbulimin e temave në përgjithësi, por që ju mungon profililizimi në tema të ndjeshme. Sipas tyre, gjatë përgatitjes së artikujve dhe akterëve të përfshirë në to, nuk ka ndonjë kriter specifik të caktuar, mirëpo në rastin e përfshirjes së grave më shumë merren "parasysh gratë të cilat janë në pozita të rëndësishme". Po ashtu, sipas tyre "zakonisht i është kushtuar rëndësi tematikës së rastit. Edhe personazhet janë përzgjedhur në bazë të kësaj, natyrisht i është kushtuar mjaft rëndësi edhe vërtetësisë së rastit,

46 Në kuadër të intervistave pjesëmarrës kanë qenë: një ish kryeredaktore dhe një redaktor nga gazeta Bota Sot, si dhe një kryeredaktor nga gazeta Epoka e Re.

kontaktimin e palëve të përfshira, etj". Kjo lë të kuptohet se gjatë realizimit të artikujve, mediat e shkruara kanë marrë parasysh suksesin e treguar apo postin politikë të grave. Gjatë zhvillimit të intervistës, ata/ato janë shprehur se në këtë drejtim, merret për bazë "puna dhe suksesi i tyre (grave) i treguar gjatë aktivitetit në fjalë", mandej kriteri profesional i cili luan rol se si pasqyrohet një artikull, si dhe "ndonjë grua që ka mbajtur poste të larta publike".

Lidhur me rolin e gazetarëve në mediat, përkatësisht imazhin në medie, të intervistuarit janë të mendimit se roli i gazetarëve në përgjithësi është shumë i rëndësishëm në imazhin mediatik. Sipas tyre "Roli i gazetarëve në imazhin mediatik është mjaft i rëndësishëm. Mirëpo gazetarët e kanë mjaft të vështirë të profilizohen vetëm në një fushë të caktuar, duke qenë se skenën mediatike në të shumtën e rasteve e dominon politika dhe zhvillimet e saj". Të intervistuarit e tjerë janë të mendimit se "profesionalizmi është ai i cili dallon gazetarët, sipas tyre roli i gazetarëve për të dy gjinitë është i njëjtë. Mirëpo, këtu dallon më shumë sektori se çka në të vërtetë gazetaret përcjellin apo shkruajnë. Përndryshe puna dhe ngarkesa është e njëjtë". Sa i përket imazhit ata/ato mendojnë që "përgatitja e gazetarëve ia ngritin ose ulin imazhin medies". Megjithëse, gjatë intervistave është vërejtur se pjesëmarrësit janë të mendimit se shpeshherë në rastet kur gratë moderojnë ose intervistojnë, më shumë vlerësohet "pamja fizike se sa elaborimi i temave, përkatësisht trajtimi i temës". Në anën tjetër, ka mendime se "gazetarët në përgjithësi, janë të përgatitur për atë që shkruajnë apo flasin në mediat televizive. Megjithatë, shumë mediume online, gazetarët janë ata që nuk kanë ndonjë fushë të specializuar, pasi që merren edhe me politikë edhe me ekonomi, apo edhe me gjëra të tjera. E kjo paska e zbehë gazetarin të jetë profesionalisht në një fushë. Në anën tjetër, kjo edhe e ka anën e vet pozitive, pasi që janë të njoftuar me shumë sfera dhe ndoshta dikujt i duhet njohuri më e madhe".

Një çështje e cila ka zënë hapësirë të konsiderueshme gjatë intervistave, ka qenë edhe trajtimi i temave ditore mbi baza gjinore, përkatësisht konteksti diskriminues (pozitiv apo negativ). Lidhur me këtë çështje, pjesëmarrësit janë shprehur se "gjatë periudhës edhe ata/ato kur kanë qenë gazetarë, por edhe tani, kanë treguar kujdes në trajtimin e temave të tilla, sidomos ndaj grave duke u kujdesuar që t'i trajtojnë në bazë të sensivitetit që kanë". Ndërsa, një tjetër intervistuese, lidhur me këtë temë në mes tjerash thekson se "në median ku kam punuar kemi trajtuar tema që kanë pasur të bëjnë me

barazinë gjinore. Por, kjo ka ndodhur thuajse vetëm në rastet kur tematika kanë qenë gratë në politikë. Edhe sa i përket aspektit diskriminues janë trajtuar tema ku gratë janë ofenduar në mënyra të ndryshme. P.sh. rasti kur një deputet i Kuvendit të Kosovës ishte kundër njohjes së statusit për gratë e dhunuara seksualisht gjatë luftës".

Megjithëse, gjatë analizës së artikujve, është vërejtur trajtimi i këtyre temave si nga konteksti i diskriminimit pozitiv po ashtu edhe negativ. Lidhur me këtë çështje, një intervistues shprehet se "natyrisht që kemi trajtuar tema edhe mbi baza gjinore, mirëpo asnjëherë nuk e mendoj që kemi pasur raste të trajtimit në kontekstin diskriminues. Nëse kemi folur për një grua të suksesshme ajo ka qenë pozitive për të në aspektin profesional, por nëse ka ndodhur e kundërta nuk do të thotë se e kemi diskriminuar, por ka ndodhur për shkak të performancës negative gjatë punës së saj".

Pjesëmarrësit gjatë intervistimit kanë potencuar faktin se në pjesën më të madhe të mediave jo vetëm të shkruara, por edhe atyre elektronike, "kryesisht gratë dhe vajzat kanë udhëheqë administratën, marketingun por edhe kanë punuar si gazetare të fushave të ndryshme", por në pozitat e larta redaktoriale, kryesisht kanë dominuar burrat. Natyrisht që ky këndvështrim dallon tek të intervistuarit e të tjera dhe në këtë pikë ata/ato shprehen se "shumica janë në pozita të mira. Asnjë prej tyre nuk mbanë një pozitë të cilën nuk e meriton". Në gazetën tonë, "momentalisht e kemi grua drejtoreshën dhe kryeredaktoren. Pra, roli i femrës në media është i madh dhe pozitiv", që do të thotë se avancimi i gruas është reflektuar edhe në mediat e shkruara, përkatësisht në pozita redaktoriale dhe kryeredaktoriale.

Sa i përket portretizimit të grave në mediat e shkruara, pjesëmarrësit kanë komentuar këtë temë, duke nënvizuar se gratë kryesisht portretizohen në atë mënyrë që e forcojnë stereotipet gjinore, duke i portretizuar ato sipas "dukjes së tyre, stilit të komunikimit dhe prezantimit në media". Gjithashtu, lidhur me këtë temë, një mendim të përafërt shprehet edhe një intervistuese tjetër, e cila thekson se: "zhvillimi i teknologjisë dhe rrjetet sociale duket se kanë ndikuar që gruaja në media të portretizohet dhe të bëhet temë vetëm sa i përket pamjes së saj fizike. Megjithatë, fakti që në krye të shtetit kemi një presidente grua, ka ndryshuar paksa këtë perceptim".

Pjesë thelbësore e burimit të lajmeve/storieve dhe promovimit të grave në media, ka qenë pikë e rëndësishme në këto intervista, ku pjesëmarrësit në përgjithësi theksojnë se gratë janë pjesë thelbësore e trajtimit të temës/temave, por që vërehet që kryesisht dominojnë burrat. Sa i përket promovimit, kryesisht kjo ndodhë kur gratë janë në stadet më të larta të afirmimit, famës apo prestigjit shoqëror dhe shpeshherë për shkak të dinamikës së kohës burrat janë ata pranojnë të jenë pjesë e storieve ose artikujve. Por kohët e fundit vërehet një ndryshim i balancuar, sa i përket gatishmërisë së burrave po ashtu edhe grave për të qenë pjesë e trajtimit të temave ose artikujve të caktuar. Sipas të intervistuarve, sot "kemi gra të shumta që përfaqësojnë institucione e organizata të ndryshme. Kjo bën që zëri i tyre të jetë mjaft i pranishëm në media, si burim informacioni", si dhe "mediat ju kanë dhënë hapësirë secilës grua në Kosovë".

Lidhur me mekanizmat e brendshëm në medie për përzgjedhjen e individëve për të realizuar një storie të caktuar e cila do të reflektonte në përfaqësimin e baraspeshuar gjinor, mediat kryesisht e bëjnë këtë në bazë të rëndësisë së stories dhe nuk kanë ndonjë mekanizëm të rregullt i cili do të analizonte dhe do të rekomandonte përzgjedhjen e individëve për të trajtuar temat, në mënyrë sa më përmbajtjesore. Në këtë rast, të intervistuarit shprehen se: "nuk ekziston një mekanizëm i tillë. Por, gazetarët e redaktorët në bazë të temave që trajtojnë e dinë se cili personazh është i thirrur për të folur", si dhe "mediat nuk shkruajnë e as nuk bëjnë storie vetëm pse duhet, apo pse është në një post publik një grua apo burrë. Nuk ka nevojë të ketë përzgjedhje se kush duhet të jetë në storie të caktuara. Kjo varet prej aktualitetit politik dhe jo se kush kë dëshiron ta promovojë në storie të ndryshme".

Në përgjithësi, gjatë intervistave të thella, është vërejtur nevoja dhe domosdoshmëria për trajnimin e gazetarëve të rinj. Gjithashtu, organizimi i tryezave të përbashkët me kryeredaktorë dhe redaktorë të mediave, është shumë i rëndësishëm për politikat redaktuese drejt ngritjes së cilësisë së shkrimeve/artikujve, në mënyrë që ato të jenë sa më objektive, profesionale dhe mbi të gjitha të balancuara në aspektin gjinorë.

# Përfundimet dhe rekomandimet

Bazuar në të gjeturat e hulumtimeve të zhvilluara dhe analizës e materialit të mbledhur për prezantimin e grave në mediat e shkruara për vitet 2016-2019, si dhe gjetjet nga intervistat e realizuara me kryeredaktor dhe redaktor të mediave të shkruara, janë nxjerrë rekomandimet e mëposhtme, si vijon:

- Të krijohen mekanizma të brendshëm të mediave (të shkruara dhe elektronike) me qëllim të balancimit të raportimeve gjinore, bazuar standardet ndërkombëtare të raportimit - Treguesit e Ndjeshëm Gjinorë për Media (GSIM) të UNESCO-s.

- Është e nevojshme që të profilizohen gazetarët në fushat konkrete për raportim, me theks të veçantë, trajnimet e specializuara të fushës.

- Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe mediat, të krijojnë një plan vjetor për trajnime sipas fushave specifike, për integrimin e indikatorëve gjinorë për të përcjellë trendët e zhvillimeve globale dhe lokale.

- Agjencia për Barazi Gjinore, mund të jetë partnerë në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të mediave për informimin dhe raportim të balancuar gjinorë në frymën e Ligjit për Barazi Gjinore, në mënyrë që të zbatohen standardet dhe indikatorët e ndjeshëm gjinorë.

- Agjencia për Barazi Gjinore, duhet të avancoj bashkëpunimin me mediat dhe shoqërinë civile, për të diskutuar lidhur me gjuhën denigruese dhe stereotipizuese, që shpërfill dhe krijon imazh negativ gjinor.

- Autoriteti rregullativ për medie, duhet të monitoron gjuhën e përdorur në medie, me ndjeshmëri gjinore në frymën e parimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Barazi Gjinore.

- Mediat duhet të angazhohen për një përfaqësim sa më të balancuar gjinorë, në të gjithë hierarkinë e mediave, duke përfshirë edhe nivelet redaktoriale.

- Media duhet të përfshijë si burim informacioni edhe ekspertë të medias dhe gjinisë në trajtimin e temave të ndryshme, sidomos temave që kanë të bëjnë me përfaqësimin dhe prezantimin e grave në medie, si dhe indikatorët gjinorë të mediave të UNESCO-s, të jenë pjesë e studimeve të gazetarisë, me qëllim që të jetë një kurrikulë trajnuese adekuate.

# Referencat


- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli I, neni 22, Kapitulli II, neni 24, paragrafi 1 dhe 2.
- Ali, Azkiya, Fariza: "*Some Fundamental Theories of Critical Discourse*", Department of English, Faculty of Teachers Training and Education, University of Lancang Kuning.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës: "*Anketa e Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2020*", Seria 5: Statistikat Sociale, ASK, Prishtinë, 2020.
- Anitasari, Deti: "*Critical Discourse Analysis: Mass Media*", Department of English Education, Faculty of Teacher Training and Education, Universitas Lancang Kuning.
- Baker, Paul and McGlashan, Mark: "*Critical Discourse Analysis*", Baker, P. & McGlashan, M. (2020) 'Critical Discourse Analysis'. In: Adolphs, S. & Knight, D. (Eds.) The Routledge Handbook of English Language and the Digital Humanities. London: Routledge.
- Berisha, Ibrahim: "*Medie – Agjensët e Komunikimit*", AAB, Prishtinë.
- Council of Europe: "*Analytical Report Gender Equality Commission Steering Committee on Media and Information Society*", Council of Europe, Strasbourg, July 2020.
- Çoşkun, Gül Esra: "*Use of Multimodal Critical Discouse Analysis in Media Studies*", The Online Journal of Communication and Media – July 2015, Volume 1, Issue 3.
- European Commission: "*A Union of Equality: Gender Equality Strategy 2020-2025*".
- Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 2.
- Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 3.
- Këshilli i Evropës: "*Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje*", KE, Stamboll, 11.V.2011, neni 14.
- Kolgeci, Sulçe Valbona: "*Të ndryshosh narrativën për gratë në media*", FES, Tiranë, 2020.
- Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave, UNFPA, Tiranë.
- Mc Lean Iain "*Fjalor Politik i Oxfordit*", Shtëpia e librit dhe

komunikimit, Tiranë, 2001.

- Mema, Bresida: "*Barazia Gjinore në Media*", Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë, 2004.
- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë: "*Gratë në Ekstremizmin e Dhunshëm - Mësimet e nxjerra nga Kosova*", QKSS, Prishtinë.
- Sinani, Resul & Matoshi, Erzë: "*Portretizimi i gruas në reklamat e birrës PEJA*", Euser, Prishtinë, 2020.
- Yang Yang: "*A social Semiotic Approach to Multimodal Discourse of the Badge of Xi' and Jiaotong University*", Theory and Practice in Language Studies, Vol. 6, No. 8, pp. 1596-1601, August 2016.
- Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: "*Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010 - 2011*", ABGJ, Prishtinë.
- Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: "*Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2014-2015*", ABGJ, Prishtinë.
- Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore: "*Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024*", AGJB, Prishtinë, 2020.

# Artikuj


- GMMP: "*The Global Media Monitoring Project*", shih: https://ëhomakestheneës.org/ëp-content/uploads/ëho-makes-the-neës/Imported/reports_2010/highlights/highlights_en.pdf
- Hoxhaj, Albiona: "*Gratë ende paraqiten në kuzhinë e pa rol në shoqëri në reklama*", artikull i botuar në Kosovalive.org me datë 07 korrik 2020, shih: https://kosovalive.org/2020/07/07/grate-ende-paraqiten-ne-kuzhine-e-pa-rol-ne-shoqeri-ne-reklama/, qasur më 19.06.2021.
- International Media Support: "*Ëomen in media: Balance the imbalance!*", IMS, publikuar në mars, 2020, shih: https://ëëë.mediasupport.org/publication/ëomen-in-media-balance-the-imbalance/#main-menu-toggle.
- Këshilli i Pavarur i Mediave të Shkruara: "*Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës*", KPMSH, shih: http://ëëë.presscouncil-ks.org/ëp-content/uploads/2015/04/Press-Code-for-Kosovo_alb.pdf
- Norzom, Tenzin: "*Global neës media lacks ëomen's perspective: Report*", publikuar në 11 dhjetor, 2020, shih: https://yourstory.com/herstory/2020/12/global-neës-media-lack-ëomens-perspective-report/amp.
- O'Keeffe, Anne: "*Media and discourse analysis*", shih: https://dspace.mic.ul.ie/bitstream/handle/10395/1681/O%20?sequence=2.
- UNESCO: "*Gender-Sensitive Indicators for Media – Frameëork of Indicators to Gauge Gender Sensitivity in Media Operations and Content*", Paris, 2012, shih: https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000217831.

# Ueb faqe/linçe

- https://eur-lex.europa.eu
- https://ec.europa.eu
- https://ballkani.info.
- https://wearesocial-net
- https://presscouncil-ks.org
- http://agk-ks.org
- https://www.judoinside.com
- https://sunnyhillfestival.com
- https://www.kultplus.com

